REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"

FAKULTETI I EDUKIMIT DHE SHKENCAVE SHOQËRORE

NJËSIA BAZË E HISTORISË, ANTROPOLOGJISË DHE GJEOGRAFISË

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë

Bachelor në "Histori-Gjeografi"


Grupi i Vlerësimit të Brendshëm:

1. Prof. as.dr. Albina SINANI (Kryetar)
2. Prof. dr. Shyqyri HYSI (Anëtar)
3. Prof. as.dr. Valbona DURI (Anëtar)
4. Dr. Mariglen SHERIFAJ (Anëtar)
5. Kostandina RRAPO (Anëtar)


Shtator/2023

## PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

### Përshkrim përmbledhës (200 -400 fjalë)

Programi i ciklit të parë të studimeve, "Bachelor" në Histori-Gjeografi (ish-dega Histori-Gjeografi), u hap për herë të parë në vitin 1969, kur në Gjirokastër u krijua Instituti Pedagogjik 2-vjeçar pa shkëputje nga puna, me degët Gjuhë-Letërsi, Histori-Gjeografi, Matematikë-Fizikë dhe Biologji-Kimi.

Në mbështetje të shkresës së Ministrisë së Arsimit dhe e Kulturës, DAL, Nr. 714 Prot., datë 6.3.1971 dhe në mbështetje të VKM Nr.4, datë 8.1.1971, u hap "Instituti pedagogjik", me afat studimi 3 vjeçar, për vitin akademik shkollor 1971-1972, me degët Matematikë-Fizikë dhe Histori-Gjeografi, në rrethet Gjirokastër (*18 studentë*) dhe Sarandë (*22 studentë*).

Në mbështetje të shkresës së Ministrisë së Arsimit, DAL, Nr. 4964/3 Prot., datë 3.12.1991 dhe në mbështetje të VKM Nr.414, datë 12.11.1991, mbi bazën e Institutit të Lartë Pedagogjik "Eqrem Çabej" në Gjirokastër, u krijua Universiteti i Gjirokastrës me 3 fakultete, një ndër të cilët ishte Fakulteti i Shkencave Shoqërore, me degët Gjuhë-Letërsi dhe Histori-Gjeografi.

Ky program ofrohet nga Departamenti i Historisë, Antropologjisë dhe Gjeografisë, Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore, Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastër. Regjistrimi i formës së diplomës "Bachelor" në Histori-Gjeografi, u bë me Urdhër të MASH Nr. 334, datë 13.07.2011, Nr. 3737/1 Prot.

Me miratimin e Ligjit për Arsimin e Lartë në Shqipëri (2007) dhe hartimin e Strategjisë Kombëtare të Arsimit të Lartë (2008-2013), në pajtueshmëri me Procesin e Bolonjës dhe prioritetet e zhvillimit të arsimit të lartë në Bashkimin Evropian, Departamenti i Historisë dhe Departamenti i Gjeografisë, morën në shqyrtim rishikimin dhe përshtatjen e programit të studimit, mbështetur në paragrafin 1.1 pikat a, b, c, të nenit 15 të Ligjit nr. 10307, datë 22. 07. 2010 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9741, datë 21. 05. 2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë*" (i ndryshuar) dhe ndryshuan emërtimin nga "*Diplomë e nivelit të parë në Histori dhe Gjeografi*" në Diplomë Universitare *"Bachelor" në Histori-Gjeografi*, i shtrirë në 3 vjet, me 180 ECTS.

Nga viti akademik 1968-1969 deri në vitin akademik 2022-2023 janë diplomuar gjithsej **3000** studentë, që krahasuar me programet e tjera, që ofrohen nga Njësia bazë, zë peshën më të lartë, me impakt lokal, rajonal, kombëtar e më gjerë, në trojet shqiptare përtej kufirit.

Studentët e diplomuar, janë punësuar si mësues të Historisë e Gjeografisë në AMU e AML, specialistë në administratën publike *(arkivistë, punonjës në sektorin e trashëgimisë së të mirave materiale dhe kulturore)*, specialistë të mjedisit e turizmit, specialistë në sektorët kërkimorë të institucioneve shkencore etj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

# PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË BRENDSHËM

## Përshkrim përmbledhës (200-400 fjalë)

Akreditimi i programit më të vjetër të studimit, një ndër programet më të rëndësishëm të UGJ, është kërkuar vazhdimisht. Qysh nga viti 2009, Departamenti i Historisë dhe Departamenti i Gjeografisë kanë hartuar raporte vjetore të vlerësimit të brendshëm të programit. Pas akreditimit institucional periodik, me Vendim të BA Nr. 55, datë 16.12.2021, Rektorati dhe njësitë drejtuese të institucionit filluan punën për akreditimin e programeve të studimit, si pjesë e Strategjisë së zhvillimit të Institucionit 2020-2025, për të rritur cilësinë e programeve të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve, si pjesë e programit të transparencës në nivel rajonal dhe kombëtar.

Në vitin 2022, Institucioni paraqiti kërkesën pranë ASCAL për akreditimin e 20 programeve të studimit. ASCAL dha konfirmimin e aplikimit për akreditimin e 20 programeve të studimit, me shkresën Nr. 112/1 Prot., datë 06.03.2023. Më pas, me shkresën e Rektorit Nr. 548 Prot., datë 17.03.2023, u vu në dijeni FESHSH, për fillimin e procesit të akreditimit të parë për 7 programet e studimit, të ofruara nga njësitë bazë të Fakultetit. Njësia bazë, në mbledhjen e saj të datës 12.04.2023, pas diskutimeve në unanimitet, miratoi GVB, për akreditimin e programit të ciklit të parë "Bachelor" në Histori-Gjeografi dhe ia propozoi Dekanit për miratim. Me miratimin e propozimit, nisi menjëherë puna për verifikimin e dokumentacionit të dosjes së akreditimit dhe përcaktimit të afateve kohore, në përputhje edhe me agjendën e dërguar nga ASCAL, të dërguar në FESHSH, nga koordinatori i UGJ.

Me Vendim Departamenti, Nr.6 datë 12.04.2023, për akreditimin e programit, u ngrit GVB, i cili hartoi RVB. Në këtë grup morën pjesë katër anëtarë të Njësisë bazë si dhe një student në këtë program studimi, i zgjedhur me propozimet e studentëve dhe personelit akademik të angazhuar në programin e studimit.

Hartimi i RVB është kryer sipas formatit të hartuar nga ASCAL. Puna nisi fillimisht me trajnimin e GVB nga stafi i ASCAL, gjatë të cilit u vunë në dispozicion materiale udhëzuese për vlerësimin, organizimin e grupit dhe procesin, detyrat, të drejtat dhe përgjegjësitë e secilit anëtar.

Gjatë hartimit të RVB, GVB me mbledhje të protokolluara, zhvilloi shumë takime pune, në bashkëpunim me drejtuesin e Njësisë bazë, duke grumbulluar, verifikuar e studiuar dokumentacionin me evidencat specifike të domosdoshme, në bashkëpunim me autoritetet drejtuese të institucionit, personelin akademik, studentët, sekretarinë mësimore, Zyrën e Financës, Zyrën për Marrëdhëniet me Jashtë, Drejtorinë e shërbimeve ndihmësakademike-administrative, Sektorin e standarteve dhe kurrikulave, Teknologjisë së informacionit etj.

Adresa: "Rruga Studenti"
"Lagjja 18 Shtatori", Gjirokastër 6001
Tel : +355 (04) 222-43423
Website : https://uogj.edu.al/
Email: dekanifeshsh@uogj.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPERISE UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTER

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Histori-Gjeografi"

### I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

| **Standardi I.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastër (UGJ), ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.<br>**[EVIDENCA I.1.** Statuti i UGJ, Neni 2, Neni 8 pika 5, Neni 63 pika 7]<br>Këto programe studimi synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.<br>**[EVIDENCA I.1.** Statuti i UGJ, Neni 5, pika c]<br>Vizioni synon një sistem arsimor cilësor, të bazuar në parimet e gjithëpërfshirjes dhe të të mësuarit gjatë gjithë jetës, që mundëson zhvillimin e potencialit të individit, duke kontribuar në mirëqënien personale të tij, si dhe në forcimin e demokracisë dhe integrimin e vendit në Bashkimin Evropian.<br>[Ligji Nr. 80/2015, Neni 1 pika ç]<br>Institucioni synon të jetë model i arsimit të lartë publik, të arrijë standarte cilësore në fushën akademike dhe të përgatisë profesionistë të zotë sipas programeve përkatëse të studimit, të rritë cilësinë e kërkimit në fushat prioritare të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit, të jetë qendër e rëndësishme e zhvillimit të qëndrueshëm të Rajonit Jugor.<br>**[EVIDENCA I.1.** Statuti i UGJ, Neni 4]<br>Institucioni ka si mision:<br>-të krijojë, të zhvillojë, të përcjellë dhe të mbrojë dijet përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve, si edhe të formojë specialistë të lartë dhe shkencëtarë të rinj;<br>-të ofrojë mundësi për të përfituar nga arsimi gjatë gjithë jetës;<br>-të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal, si dhe në forcimin e sigurisë publike dhe kombëtare;<br>-të kontribuojë në rritjen e standarteve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e studentëve për një shoqëri të tillë.<br>**[EVIDENCA I.1.** Statuti i UGJ, Neni 5, Neni 8, pika 5]<br>UGJ ofron programe studimi në përputhje me standardet më të larta akademike dhe profesionale, në përgatitjen e profesionistëve në fusha të ndryshme, me qëllim që të përgatisë profesionistë të këtyre fushave dhe të çojnë përpara kërkimin shkencor.<br>**[EVIDENCA I.2.** Rregullore e UGj, Neni 2]<br>**[EVIDENCA I.3.** Strategjia e zhvillimit të UGJ, 2020-2025, fq. 3, 8] |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë, mbështetur në legjislacionin e institucionit, me qëllimin që të kontribuojë në krijimin dhe zhvillimin; të përcjellë e të mbrojë dijet përmes mësimdhënies e kërkimit |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| | |
|---|---|
| | shkencor; të nxisë e të zhvillojë artet, edukimin fizik dhe sportet; të formojë specialistë të lartë; të përgatisë shkencëtarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend; të ofrojë mundësi të barabarta për të përfituar nga arsimi i lartë dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës si dhe të kontribuojë në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë, në përgatitjen e studentëve për një shoqëri të tillë. Programi i studimit synon të çojë përpara zhvillimin e traditës në fushat e mësuesisë, por edhe t'u sigurojë studentëve aftësi akademike, kulturore dhe etike të nevojshme, që mund t'i ndihmojnë ata të jenë në gjendje të kontribuojnë në shërbim të zhvillimit rajonal dhe kombëtar.<br>**[EVIDENCA I.1.** Statuti i UGJ, Neni 4, Neni 5, Neni 8**]**<br>**[EVIDENCA I.3.** Strategjia e zhvillimit të UGJ, 2020-2025, fq. 8**]**<br>**[EVIDENCA I.4.** Plani strategjik i zhvillimit të FESHSH 2020-2025, fq. 9-10**]**<br>Programi i studimit "Bachelor" në Histori-Gjeografi është plotësisht në përputhje me qëllimet dhe misionin e UGJ si dhe me fushën e veprimtarisë së tij.<br>**EVIDENCA I.5.** Njoftime shtypi për Filiale të Arsimit të Lartë në Gjirokastër]<br>**[EVIDENCA I.6.** Vendimi i hapjes së ILP & Vendimi i krijimit të UGJ]<br>**EVIDENCA I.7.** Vendimi i krijimit të Njësisë kryesore të FESHSH]<br>**EVIDENCA I.8.** Vendimi i hapjes së programit të studimit]<br>Programi synon të promovojë përgatitjen e kualifikuar të studentëve dhe studiuesve të rinj, në fushën e studimeve historike dhe gjeografike<br>**[EVIDENCA I.9.** Rregullore e studimeve në UGJ, Neni 4, Neni 6]<br>**[EVIDENCA I.10.** Rregullore e programit të studimit, Neni 8**]** |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij. | Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.<br>**[EVIDENCA I.3.** Strategjia e zhvillimit të UGJ, fq. 8**]**<br>**[EVIDENCA I.4.** Plani strategjik i zhvillimit të FESHSH 2020-2025, fq. 9-10**]**<br>**[EVIDENCA I.11.** Plani strategjik i zhvillimit të Departamentit 2020-2025**]**<br>**[EVIDENCA I.12.** Plani i zhvillimit të Departamentit 2021-2026]<br>**[EVIDENCA I.1.** Statuti i UGJ, Neni 62, Neni 63, Neni 65**]**<br>**[EVIDENCA I.2.** Rregullore e UGj, Neni 42, Neni 46, Neni 48**]**<br>**[EVIDENCA I.13.** Raport vjetor i UGJ 2020-2021]<br>**[EVIDENCA I.14.** Raport vjetor i UGJ 2020-2021]<br>**[EVIDENCA I.15.** Raport vjetor i FESHSH 2020-2021]<br>**[EVIDENCA I.16.** Raport vjetor i FESHSH 2021-2022]<br>**[EVIDENCA I.17.** Raport vjetor i Departamentit 2020-2021]<br>**[EVIDENCA I.18.** Raport vjetor i Departamentit 2021-2022]<br>Pas përfundimit me sukses të programit, të diplomuarve u mundësohet të ndjekin ciklin e dytë të studimeve në *"Master profesional" në mësuesi në Histori-Gjeografi*, *"Master i shkencave" në arkeologji dhe administrim i pasurive arkeologjike*, *"Master i shkencave" në Arkeologji, Histori dhe Administrim i Pasurive Kulturore*, program i përbashkët me Universitetin e Maceratës, me diplomë të dyfishtë.<br>**[EVIDENCA I.10.** Rregullore e programit të studimit, Neni 8]<br>Administrimi i programit të studimit realizohet duke u mbështetur në Nenin 75, të Ligjit Nr. 80/2015, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, në Udhëzimin nr.31, datë 29.12.2017, "Për përcaktimin e kritereve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe |

Adresa: "Rruga Studenti"
"Lagjja 18 Shtatori", Gjirokastër 6001
Tel : +355 (04) 222-43423
Website : https://uogj.edu.al/
Email: dekanifeshsh@uogj.edu.al

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| | |
|---|---|
| | mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë", në VKM nr.185, datë 25.3.2021 për ndryshime në VKM nr.41, datë 24.1.2018 "*Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL e RSH*", duke respektuar lirinë akademike, të drejtat dhe detyrimet e personelit akademik dhe të studentëve. |
| **Kriteri 4.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | Institucioni demonstron se ka një përvojë 52 vjeçare, me kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në fushën e Historisë dhe Gjeografisë, *si më poshtë vijon*:<br>-me VKM, Nr.4, datë 8.1.1971, u hap "Instituti pedagogjik", me afat studimi 3 vjeçar, për vitin akademik 1971-1972.<br>-me VKM, Nr. 414, datë 12.11.1991, mbi bazën e Institutit të Lartë Pedagogjik, "Eqrem Çabej", u krijua Universiteti i Gjirokastrës, me Fakultetin e Shkencave Shoqërore, me degët gjuhë-letërsi dhe histori-gjeografi. [https://uogj.edu.al/uogj/historiku/]<br>**[EVIDENCA I.5.** Njoftime shtypi për Filiale të Arsimit të Lartë në Gjirokastër**]**<br>**[EVIDENCA I.6.** Vendimi i hapjes së ILP & Vendimi i krijimit të UGJ**]**<br>**[EVIDENCA 1.19.**Vendimi i Akreditimit Periodik Institucional]<br>Institucioni, në funksion të programit të studimit ofron të gjithë burimet njerëzore dhe infrastrukturore të FESHSH si edhe bibliotekën. |
| **Kriteri 5.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | Programi i studimit Bachelor në "Histori-Gjeografi" është program i nivelit 6 sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve [Ligj Nr. 23/2018 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nrr. 10 247, datë 4.3.2010, "*Për kornizën shqiptare të kualifikimeve*"]<br>**[EVIDENCA I.1.** Statuti i UGJ, Neni 63, Neni 65**]**<br>**[EVIDENCA I.4.** Plani strategjik i zhvillimit të FESHSH 2020-2025]<br>**[EVIDENCA I.20.** Rregullore e FESHSH, Neni 4 pika 1 gërma a]<br>**[EVIDENCA I.21.** Rregullore e Njësisë bazë, Neni 28 pika 4]<br>**[EVIDENCA I.10.** Rregullore e programit të studimit, Neni 7 pika 1**]**<br>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane sipas Klasifikimit Standard Ndërkombëtar të Arsimit KSNA 2011 (ISCED 2011), Trajnimit të KSNA-së (KSNA-F 2013) dhe legjislacionit në fuqi për kodifikimin, bazuar në Nenin 86, të Ligjit Nr. 80/2015, "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*" dhe Vendimin Nr. 310, datë 11.5.2022 "*Për Specifikimet dhe Përmbajtjen e Kodifikimit të Programeve të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë të Republikën e Shqipërisë*" të Këshillit të Ministrave.<br>**[EVIDENCA I.22.** Përcjellja në MAS e propozimeve për kodifikimin e programeve të studimit]<br>**[EVIDENCA I.23.** Pasqyrimi i propozimeve për kodifikimin e programeve të FESHSH, fq. 14-15]<br>Gjithashtu, me finalizimin e aktit nënligjor, i cili udhëzon institucionet sesi duhet kryer procesi i kodifikimit (*Ligji i Arsimit të Lartë 80/2015, Neni 86*), do të kryhet plotësisht kodifikimi i programit të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare dhe evropiane.<br>Vëmë në dukje gjithashtu se në 52 vite jetëgjatësie të programit të studimit, fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit ka qenë |

Adresa: "Rruga Studenti"
"Lagjja 18 Shtatori", Gjirokastër 6001
Tel : +355 (04) 222-43423
Email: dekanifeshsh@uogj.edu.al
Website : https://uogj.edu.al/

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| | |
|---|---|
| | gjithmonë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Njësisë kryesore dhe Njësisë bazë përgjegjëse.<br>[VKM 823, dt. 05.12.2007 *"Për hapjen e njësisë kryesore FESHSH dhe departamenteve"*]<br>[Miratimi i propozimit të Rektorit për ndarjen e departamenteve]<br>Në bazë të shkresës së MAS, Nr. Prot. 1283/3, datë 25.11.2021, u konfirmua marrja në dijeni e Vendimit Nr. 44, datë 25.10.2021 të Bordit të Administrimit dhe Vendimit Nr. 32, datë 25.10.2021 të Senatit Akademik me lëndë: *"Për ristrukturimin e njësisë bazë të Historisë, Antropologjisë dhe Gjeografisë"*.<br>[**EVIDENCA I.24.** Riorganzimi i Njësisë bazë]<br>[**EVIDENCA I.25.** Riorganizimi i grupeve mësimore-kërkimore]<br>Ky ristrukturim lindi si domosdoshmëri në lidhje me aplikimin për hapjen e programit të përbashkët të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Antropologji", në partneritet me Institutin e Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, Akademia e Studimeve Albanologjike, program për të cilin Grupi i punës po vazhdon punën për plotësimin e mangësive për hapjen e tij në të ardhmen e afërt.<br>[**EVIDENCA I.26.** Vlerësimi i aplikimit për hapjen e programit "Bachelor" në Antropologji]<br>Personeli akademik mbulon lëndët mësimore në fushën e tyre të kualifikimit si dhe në përputhje me fushën e tyre të kërkimit të thelluar shkencor. Pedagogët efektivë mbulojnë 88.3% (159 kredite) të ngarkesës së programit mësimor, ndërsa pedagogët e ftuar dhe me kohë të pjesshme mbulojnë 11.7% (21 kredite) të ngarkesës mësimore. |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi I.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. | Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre. Marrëdhëniet e bashkëpunimit rregullohen nëpërmjet Statutit dhe Rregullores së UGJ, në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 80/2015.<br>Institucioni përfaqëson një strukturë të integruar të përbërë nga njësi kryesore, njësi bazë dhe njësi ndihmëse, si Bordi i Administrimit, i cili ka lidhje me personelin ndihmësakademik. Institucioni drejtohet dhe kontrollohet nga autoritetet dhe organet drejtuese, që organizohen me një hierarki, me kompetenca të përcaktuara në Ligjin e Arsimit të lartë, në Statut, në Rregullore si dhe në aktet e brendshme vetërregulluese të institucionit.<br>[**EVIDENCA I.1.** Statuti i UGJ, Kreu II, III, IV, V]<br>[**EVIDENCA I.2.** Rregullore e UGJ, Kreu II, III, IV, V] |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| | |
|---|---|
| | **[EVIDENCA I.27.** Organograma e UGJ]<br>**[EVIDENCA I.28.** Organograma e FESHSH]<br>Veprimtaria akademike, ndihmësakademike dhe administrative e institucionit, pasqyrohet në raportet vjetore institucionale, mbi veprimtarinë mësimore-kërkimore të Njësisë kryesore/bazë.<br>**[EVIDENCA I.2.** Rregullore e UGJ, Neni 4, Neni 5 dhe Neni 6]<br>**[EVIDENCA I.15.** Raport vjetor i FESHSH 2020-2021]<br>**[EVIDENCA I.16.** Raport vjetor i FESHSH 2021-2022]<br>**[EVIDENCA I.17.** Raport vjetor i Departamentit 2020-2021]<br>**[EVIDENCA I.18.** Raport vjetor i Departamentit 2021-2022]<br>Departamenti, për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programeve te studimit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit mes FESHSH, FSHN dhe FE, si edhe brenda FESHSH, midis Njësive bazë **[ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE** - Tabelat 4 Ngarkesa totale e personelit akademik të programit Bachelor në "Histori-Gjeografi" në një vit akademik] |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | Institucioni, për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj, me qëllim zgjerimin dhe konkretizimin e marrëdhënieve në të gjitha format e bashkëpunimit ndërkombëtar, në funksion të mësimdhënie/mësimnxënies dhe kërkimit shkencor.<br>**[EVIDENCA I.29.** Strategjia e UGJ për Ndërkombëtarizimin, pika A]<br>**[EVIDENCA I.30.** Strategjia për Kërkimin Shkencor në UGJ, fq. 4]<br>**[EVIDENCA I.31.** Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit]<br>**[EVIDENCA I.32.** Lista e projekteve]<br>**[EVIDENCA I.33.** Lista e mobiliteteve]<br>Nëpërmjet marrëveshjeve, sigurohen marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi, ku përfitues janë studentët dhe personeli akademik, të përfshirë në një sërë projektesh, në mobilitete (Erasmus +), leksione të hapura, workshop-e, konferenca etj.<br>**[EVIDENCA I.17.** Raport vjetor i Departamentit 2020-2021]<br>**[EVIDENCA I.18.** Raport vjetor i Departamentit 2021-2022]<br>Një aset tepër të rëndësishëm në aspektin e formimit teorik dhe praktik të studentëve janë edhe aktivitetet me personalitete të shquara në fushën e historisë, gjeografisë, arkeologjisë etj, pjesë integrale e informacionit ekstrakurrikular për studentët.<br>**[EVIDENCA I.34.** Lista e leksioneve të hapura] |
| **Kriteri 3.** Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj. | Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi institucionale, për realizimin e praktikës në terren.<br>**[EVIDENCA I.31.** Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit]<br>**[ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE** – Tabela 5 Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang Programi/esh studimi për Praktikat profesionale me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë]<br>Lënda *Praktikë në terren* është e detyrueshme në planin mësimor, viti i dytë, semestri i dytë. Njësia bazë harton rregulloren e praktikës në terren, syllabusin, programin e itinerarit për realizimin e praktikës në terren, marrëveshjen me studentin dhe formularin e vlerësimit, që pasi miratohen nga Drejtuesi i Njësisë bazë, i përcillen Dekanit të FESHSH, Rektorit dhe Administratorit të UGJ, për miratimin e fondeve të nevojshme për realizimin e saj. |

Adresa: "Rruga Studenti"
"Lagjja 18 Shtatori", Gjirokastër 6001
Tel : +355 (04) 222-43423
Website : https://uogj.edu.al/
Email: dekanifeshsh@uogj.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| | |
|---|---|
| | **[EVIDENCA I.35.** Rregullore e Praktikës në terren]<br>**[EVIDENCA I.36.** Programi i itinerarit për realizimin e Praktikës në terren]<br>Njësia bazë është në proces nënshkrimi të marrëveshjeve me Institutin Meteorologjik, Gjeologjik, të Gjeoshkencave, ASIG etj. |
| **Kriteri 4.** Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. | Njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit, të vlerësimit të eksperiencës së fituar nga personeli akademik si nxitjes së mobiliteteve të personelit akademik dhe studentëve Këto raporte analitike janë pjesë integrale e raporteve vjetore mbi veprimtarinë mësimore-kërkimore të Departamentit, ku evidentohen përfitimet dhe mundësitë nga marrëveshjet në funksion të realizimit me sukses të programit të studimit.<br>**[EVIDENCA I.17.** Raport vjetor i Departamentit 2020-2021]<br>**[EVIDENCA I.18.** Raport vjetor i Departamentit 2021-2022] |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

| **Standardi II.1**<br>**Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Programi i ciklit të parë të studimeve **"Bachelor"** në **Histori-Gjeografi** (*ish-dega Histori-Gjeografi*), u hap me VKM-në, Nr. 414, datë 12.11.1991, Nr. 4964/3 Prot., me 180 kredite (ECTS) dhe kohëzgjatje 3 vite akademike.<br>Programi të studimeve "Bachelor" në Histori-Gjeografi është i ciklit të parë. Forma e studimeve është me kohë të plotë dhe gjuha e mësimdhënies është gjuha shqipe.<br>Programi është i organizuar në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 si dhe VKM Nr. 185, datë 25.3.2021 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, "*Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë*", të ndryshuar; VKM Nr. 879, datë 18.12.2019 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "*Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë*".<br>Programi është i organizuar në lëndë mësimore, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe bazohet në Sistemin Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program ka kohëzgjatje normale 3 (tre) vite akademike, 6 (gjashtë) semestra dhe 180 ECTS në total.<br>**[EVIDENCA I.9.** Rregullore e studimeve në UGJ, Neni 11 pika 1**]**<br>**[EVIDENCA I.10.** Rregullore e programit të studimit, Neni 7 pika 1, 2**]**<br>**[ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE** - Tabelat 12 Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës]<br>Në përfundim të këtij programi studimi, studentit i jepet Diplomë Universitare "Bachelor" në Histori-Gjeografi.<br>**[EVIDENCA II.1.** Regjistrimi i formës së diplomës Bachelor në H-GJ]<br>Struktura e studimeve në FESHSH përfshin lëndë sipas kategorizimit të veprimtarive formuese mbështetur në aktet nënligjore në fuqi. DHAGJ ka hartuar dhe miratuar Rregulloren e Programit të Studimit dhe bazuar në të krijon Kurrikulën e Programit të Studimit, Planin Mësimor si dhe programet e lëndëve (syllabuset) përkatëse. Në planet mësimore pasqyrohen disiplinat mësimore, raporti teori-praktikë, numri i krediteve/ECTS për secilën disiplinë, detyrimet mësimore për çdo disiplinë, mënyra dhe afatet e shlyerjes së detyrimeve (në programet lëndore), si dhe praktika në terren.<br>**[ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE** - Tabelat 12 Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës**]**<br>**[EVIDENCA I.10.** Rregullore e programit të studimit, Neni 9**]**<br>**[EVIDENCA II.2.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2020-2021**]**<br>**[EVIDENCA II.3.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2021-2022**]**<br>**[EVIDENCA II.4.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2022-2023**]** |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose | Qëllimi i programit është të përgatisë specialistë të aftë në fushën e gjeografisë ne perputhje me nevojat e tregut të punës, mësues të historisë dhe gjeografisë në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme (*pasi të kenë përfunduar Masterin Profesional*), specialistë në administratën publike (si arkivistë, punonjës në sektorin e trashëgimisë së të mirave materiale dhe kulturore), |

Adresa: "Rruga Studenti"
"Lagjja 18 Shtatori", Gjirokastër 6001
Tel : +355 (04) 222-43423
Website : https://uogj.edu.al/
Email: dekanifeshsh@uogj.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| | |
|---|---|
| punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | specialistë të mjedisit, të turizmit, specialistë në sektorët përkatës kërkimorë të intitucioneve shkencore etj. Programi ofron një formim bazë të ekuilibruar duke mundësuar kompetenca të shumëfishta për t'ju përshtatur profileve të ndryshme të punës (histori, gjeografi etj).<br>Nëpërmjet veprimtarive formuese, të parashikuara në planin mësimor studentët pajisen me njohuri bashkëkohore në fushën e historisë dhe gjeografisë, të cilat i shërbejnë studentit për marrjen e njohurive në fushat specifike dhe të specializuara që ky program ofron si dhe në përftimin e aftësive profesionale dhe kompetencave për t'i shërbyer më mirë tregut të punës.<br>Programi synon të bëjë një kombinim mes formimit akademik me aspektin praktik, veçanërisht kjo në lëndë të caktuara. Studentët të cilët ndjekin këtë program studimi kanë mundësi të vijojnë formimin e tyre akademik në programet e ciklit të dytë të studimeve Master Profesional, Master i Shkencave, apo edhe të vijojnë karrierën e tyre profesionale, duke u punësuar në sektorin publik apo privat.<br>[**ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE** - Tabelat 12 Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës]<br>[**EVIDENCA I.10.** Rregullore e programit të studimit, Neni 9]<br>[**EVIDENCA II.2.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2020-2021]<br>[**EVIDENCA II.3.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2021-2022]<br>[**EVIDENCA II.4.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2022-2023] |
| **Kriteri 3.** Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. | Programi i studimit është i mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 41, datë 24.01.2018, "*Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë*", Vendimin Nr. 879, datë 18.12.2019 "*Për disa ndryshime dhe shtesa*" në Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, të Këshillit të Ministrave, "*Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë*", Vendimin Nr. 185, datë 25.03.2021 "*Për disa ndryshime dhe shtesa*" në Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, "*Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë*", të ndryshuar si dhe në Rregulloren e studimeve në UGJ.<br>Ky program studimi, referuar Rregullores së tij, organizohet në module/lëndë që vlerësohen në kreditë ECTS. Në këtë program studimi, veprimtaritë formuese grupohen në kategoritë e mëposhtme, me kreditet dhe përqindjet përkatëse që zënë, sipas përcaktimeve të bëra mbi bazën e VKM-së së sipërpërmendur (VKM Nr.41, dt. 24.01.2018 "*Për elementët e programeve të studimit të ofruarar nga institucionet e arsimit të lartë*", i ndyshuar).<br>Programi i studimit Histori-Gjeografi është i organizuar me kohë të plotë në tre vite akademike të ndarë në 6 semestra në total 180 ETCS (ose 2029 orë mësimore në auditor). Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike të cilat në të gjashtë semestrat janë organizuar në orë mësimore në auditor (leksione/seminare) dhe jashtë auditorit. Frekuentimi i orëve në auditor është i detyrueshëm për studentin në masën 80%. Veprimtaritë formuese brenda programit të studimit përmbajnë elementet sipas komponentit mësimor:<br>A. LËNDË BAZË të programit të studimit, që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme *(15-20% e totalit të krediteve të këtij programi, ose 27-36 kredite/* |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| | |
|---|---|
| | *ECTS*). Në planin mësimor janë 7 lëndë, në total 36 kredite/ECTS në programin aktual.<br>B. LËNDË KARAKTERIZUESE, që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik, sipas karakteristikave të tij (*50-55% e totalit të krediteve të këtij program, ose 90 – 99 kredite*). Në planin mësimor janë përcaktuar 16 lëndë, në total 96 kredite/ECTS në programin aktual.<br>C. LËNDË NDËRDISIPLINORE DHE/OSE INTEGRUESE në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje. (*12-15% e totalit të krediteve të këtij program, ose 21.6- 27 kredite/ ECTS*). Në këtë kategori (në të tre vitet), në planin mësimor janë përcaktuar 10 lëndë, në total 25 kredite/ECTS. Në rubrikën Lëndë me Zgjedhje të kësaj kategorie, studenti duhet të zgjedhë 2 (dy) lëndë me nga 3 (tre) kredite/ECTS secila.<br>D. LËNDË PLOTËSUESE - gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale (*të cilat përbëjnë 10 - 15 % të totalit të krediteve të programit të studimit bachelor, ose 18-27* kredite/ECTS). Në këtë kategori *(në të tre vitet*), në planin mësimor janë përcaktuar 5 lëndë, në total 17 kredite/ECTS të programit aktual.<br>E. DETYRIMET PËRMBYLLËSE, të cilat lidhen me përgatitjen për provimin e diplomës apo tezës së diplomës *(3 - 5% e totalit të krediteve të këtij programi, ose 5.4 – 9 kredite ECTS*). Në programin aktual zë 6 kredite.<br>[**ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE** – Tabelat 9 Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E)]<br>[**EVIDENCA I.10.** Rregullore e programit të studimit Neni 9]<br>[**ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE** – Tabelat 13 Ngarkesa totale në auditor e studentëve për Format e mësimdhënies në programin e studimit, për secilin program] |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. | Programi i studimit nisur nga specifika e tij, shoqërohet me praktika mësimore, të emërtuara praktikë në terren. Në planin mësimor, praktika në terren zhvillohet në semestrin e IV, viti II me gjithsej 3 (tre) kredite/ECTS.<br>Në këtë program studimi është përcaktuar forma e detyrimeve përmbyllëse, e cila është me provim diplome ose me mbrojtje teme diplome, mbi bazën e mesatares në dy vitet e para të programit të studimit, në total me 6 kredite/ECTS.<br>[**ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE** – Tabelat 9 Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E)]<br>[**EVIDENCA I.10.** Rregullore e programit të studimit të UGJ, Neni 11] |
| **Kriteri 5.** Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin. | Forma e organizimit të studimeve është studime me kohë të plotë. Struktura e programit të studimit përmban të gjitha elementet e *VKM nr. 41, dt. 24.01.2018.*<br>*Programi* përmban:<br>- lëndët/modulet të shprehura në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS);<br>- kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit;<br>- objektivat formues dhe kompetencat profesionale;<br>- veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit;<br>- kategoritë e veprimtarive formuese që karakterizojnë programin; |

Adresa: "Rruga Studenti"
"Lagjja 18 Shtatori", Gjirokastër 6001
Tel : +355 (04) 222-43423
Email: dekanifesh@uogj.edu.al
Website : https://uogj.edu.al/

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" - GJIROKASTËR

| | |
|---|---|
| | - planin mësimor;<br>- programin lëndor (*syllabuset*), të cilat përgatiten nga titullarët e lëndëve dhe përmbajnë të gjitha elementet;<br>- diplomën dhe suplementin e diplomës.<br>Rregullorja e UGJ-së dhe Rregullorja e Programit të studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.<br>**[EVIDENCA I.2.** Rregullore e UGJ, Neni 49, 61, 65]<br>**[EVIDENCA I.9.** Rregullore e studimeve në UGJ, Neni 8, 25 pika 1, Neni 52]<br>**[EVIDENCA I.20.** Rregullore e FESHSH, Neni 17, 30]<br>**[EVIDENCA I.21.** Rregullore e Njësisë bazë, Neni 55, 56]<br>Format e financimit të studentëve përfshijnë financimin nëpërmjet bursave dhe nëpërmjet përjashtimit nga tarifat e studimit. Financimi bëhet për dy kategori. Financimi për studentët me rezultate të shkëlqyera dhe financimi i studentëve përfitues sipas kritereve të tjera të vendosura me aktet nënligjore. Në fillim të çdo viti akademik, realizohen procedurat përkatëse, sipas vendimit të Bordit të Administrimit UGJ.<br>**[EVIDENCA II.5.** Vendime të SA dhe BA për bursat]<br>**[EVIDENCA II.6** Heqja e taksës së shkollimit në programet e mësuesisë 2021-2022] |
| **Kriteri 6.** Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind. | Programi i studimit "Bachelor" në Histori-Gjeografi referuar programeve të studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë në Universitetet publike në Shqipëri (*UT, Elbasan, Shkodër, Korçë dhe Vlorë*) kanë përmbajtje të ngjashme në masën 70 %.<br>Në zbatim të Urdhërit Nr. 225, datë 07.05.2018 të MASR "*Për përafrimin e përmbajtjes së programeve të studimit në fushën e mësuesisë të institucioneve të arsimit të lartë*", DHAGJ është përfaqësuar me anëtarët e tij në grupet e punës sipas profileve të ngritura për rishikimin dhe përafrimin e përmbajtjes së programeve të studimit në fushën e mësuesisë, që ofrojnë institucionet e arsimit të lartë dhe janë hartuar nga grupet përkatëse raportet finale për përafrimin e programeve të mësuesisë në masën 70%.<br>[Urdhër Nr.225 datë 07.05.2018 MASR]<br>**[EVIDENCA II.7.** Përafrimi i programeve në fushën e mësuesisë] |
| **Kriteri 7.** Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit. | DHAGJ bazuar në Nenin 86 të Ligjit Nr. 80/2015, "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*" dhe Vendimin Nr. 310, datë 11.05.2022 "*Për Specifikimet dhe Përmbajtjen e Kodifikimit të Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë të Republikën e Shqipërisë*" të Këshillit të Ministrave ka propozuar kodifikimin kombëtar të programit të studimit "Bachelor" në Histori-Gjeografi dhe është në pritje të aprovimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS). Më tej do të propozohet dhe kryhet kodifikimi i lëndëve të programit të studimit.<br>**[EVIDENCA I.22.** Përcjellja në MAS e propozimeve për kodifikimin e programeve të studimit]<br>**[EVIDENCA I.23.** Pasqyrimi i propozimeve për kodifikimin e programeve të FESHSH, fq. 14-15] |
| **Kriteri 8.** Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, | Departamenti i Historisë, Arkeologjisë dhe Gjeografisë përgjegjës për programin e studimit "Bachelor" në Histori-Gjeografi synon në të ardhmen edhe hartimin e programeve të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe/ose të huaj, ndërsa hapet për |

| | |
|---|---|
| vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi. | herë të parë programi i studimit i ciklit të dytë të studimeve "*Master i shkencave*" *në Arkeologji, Histori dhe Administrim i Pasurive Kulturore*, program i përbashkët me Universitetin e Maceratës, me diplomë të dyfishtë. [Urdhër i MAS Nr. 450, datë 14.8.2023, Nr. 5117/1 Prot., "*Për hapjen e programit të përbashkët të studimit të ciklit të dytë, "Master i shkencave" në Arkeologji, Histori dhe Administrim i Pasurive Kulturore, në Universitetin "Eqrem Çabej", Gjirokastër dhe në Universitetin e Maceratës, Itali*"] |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.2**<br>**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. | Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore dhe Departamenti i Historisë, Antropologjisë dhe Gjeografisë, përmbushin detyrimet ligjore për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike, vlerësim dhe akreditim.<br>Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore i hapur me VKM 823, dt. 05.12.2007. FESHSH përbëhet nga 6(gjashtë) departamente, të cilat, bazuar në Nenin 25 të Ligjit Nr. 80/2015 të Arsimit të lartë, kanë në përbërjen e tyre të paktën shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të plotë, si personel akademik, nga të cilët të paktën tre me grada shkencore/tituj akademike, si dhe personel ndihmës akademik.<br>[VKM 823, dt. 05.12.2007 "*Për hapjen e njësisë kryesore FESHSH dhe departamenteve*"]<br>[**EVIDENCA I.20.** Rregullore e FESHSH, Neni 13]<br>[**ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE** – Tabelat 1 Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), tituj/gradat; Personeli ndihmës Akademik dhe Administrativ (PNA dhe PA)]<br>Programi i studimit në Histori-Gjeografi është hapur në vitin akademik 1971-1972 në mbështetje të shkresës së Ministrisë së Arsimit dhe Kulturës, DAL Nr. 714 Prot., datë 6.3.1971 dhe mbështetje të VKM Nr.4, datë 8.1.197.<br>[**EVIDENCA I.8.** Vendimi i hapjes së programit të studimit]<br>Programi i studimit organizohet çdo vit, sipas strukturës së vitit akademik përkatës, mbështetur në Urdhër të Ministrit të MAS dhe të miratuar në rang universiteti. Struktura përcakton ndarjen semestrale në javë mësimore (15 javë/semestër) dhe sezon provimesh (3 javë/semestër). Në strukturë përcaktohet gjithashtu edhe sezoni i provimit të diplomës.<br>[Ligjit Nr. 80/2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", Neni 25, pika 4]<br>[**EVIDENCA II.8.** Planifikimi i strukturës mësimore të vitit akademik]<br>DHAGJ si përgjegjës për programin e studimit "Bachelor" në Histori-Gjeografi ka në përbërjen e tij 11 personel akademik efektiv (PAE) dhe 7 personel akademik me kontratë (PAK) si edhe 1 (një) personel ndihmësakademik, në total 19 personel akademik dhe ndihmësakademik. |

Adresa: "Rruga Studenti"
"Lagjia 18 Shtatori", Gjirokastër 6001
Tel.: +355 (04) 222-43423
Email: dekanfeshsh@uogj.edu.al
Website : https://uogj.edu.al/

| | |
|---|---|
| | Personeli akademik mbulon lëndët mësimore në fushën e tyre të kualifikimit si dhe në përputhje me fushën e tyre të kërkimit të thelluar shkencor. Pedagogët efektivë mbulojnë 88.3% (159 kredite) të ngarkesës së programit mësimor, ndërsa pedagogët e ftuar dhe me kohë të pjesshme mbulojnë 11.7% (21 kredite) të ngarkesës mësimore.<br>**[EVIDENCA II.9.** Ngarkesa e plotë mësimore vjetore në auditor]<br>**[EVIDENCA II.10.** Pasqyrë e mësimdhënies së normuar vjetore]<br>**[EVIDENCA II.11.** Planifikimi i kohës vjetore të punës të Departamentit]<br>**[EVIDENCA II.12.** Planifikimi i kohës vjetore të punës për personelin akademik]<br>**[EVIDENCA II.13.** Planifikimi i kohës vjetore të punës për personelin ndihmësakademik]<br>**[ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE** - Tabela 7 Të dhënat përmbledhëse të stafit akademik për programin e studimit, sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre]<br>Programi i Studimit në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë është riorganizuar sipas vendimeve të mëposhtme është riorganizuar sipas vendimeve të mëposhtme:<br>Vendim Senati Akademik Nr.16, datë 23.10.2018<br>Vendim Senati Akademik Nr.17, datë 08. 07. 2021<br>**[EVIDENCA II.14.** Riorganizimi i planit mësimor 2018-2021]<br>**[EVIDENCA II.15.** Riorganizimi i planit mësimor 2021-2022]<br>UGJ ka marrë akreditimin periodik institucional me Vendim Nr.55, datë 16.12.2021 të Bordit të Akreditimit të ASCAL.<br>**[EVIDENCA I.19.** Vendimi i Akreditimit Periodik Institucional] |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj. | FESHSH/DAHGJ përmbush detyrimet e përcaktuara në Ligjin Nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", Neni 25, pika 4, duke angazhuar 1 (*një*) personel ndihmës akademik me karakter mësimor (*laborant*), i cili (plotëson kriteret e kualifikimit dhe profesionalizmit që kërkohet në këtë pozicione pune), që angazhohet në realizimin e praktikave mësimore në terren.<br>**[Evidenca I.28.** Organograma e FESHSH]<br>**[ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE-** Tabelat 1 dhe 2]<br>Në kategorinë e personelit ndihmës akademik të fakultetit/departamentit bën pjesë edhe personeli ndihmësakademik me karakter administrativ, në të cilën bën pjesë sekretaria mësimore, e cila krijon, mirëmban, administron dhe vë në dispozicion dokumentacionin e procesit mësimor. |
| **Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. | Roli i koordinatorit për programin e studimit "Bachelor" në Histori-Gjeografi mbulohet nga përgjegjësi i Njësisë bazë, i cili është autoriteti drejtues akademik. Përgjegjësi i departamentit drejton e kontrollon punën mësimore-shkencore në departament; miraton komisionet e provimeve si dhe tezat e tyre; i propozon dekanit komisionet e mbrojtjes së diplomave; drejton punën për diskutimin e ligjëratave dhe teksteve mësimore; miraton programet e lëndëve përkatëse dhe ndjek planifikimin e aktiviteteve shkencore; analizon çdo vit realizimin e detyrave të punës mësimore-shkencore të personelit akademik; propozon në Dekanat për të ftuar personel akademik për periudha semestrale ose një vjeçare të përsëritshme sipas nevojave të Departamentit; përgatit shpërndarjen e ngarkesës mësimore që miratohet në Departament; ushtron kontrolle për cilësinë e mësimdhënies; propozon masa administrative dhe disiplinore sipas rregulloreve të miratuara dhe të akteve ligjore e nënligjore ndaj personelit deri në lirimin nga detyra |

| | |
|---|---|
| | dhe studentëve deri në përjashtimin nga UGJ<br>**[EVIDENCA I.20.** Rregullore e FESHSH, Neni 11]<br>**[EVIDENCA I.21.** Rregullore e Njësisë bazë, Neni 14, pika 5 dhe 6]. |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi II.3**<br>**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. | Programi i studimit në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", me Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018 "*Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë*", Vendimin Nr. 879, datë 18.12.2019 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin* Nr. 41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave, "*Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë*", me Vendimin Nr. 185, datë 25.03.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, "Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", të Ndryshuar, me Statutin e UGJ- si dhe me Rregulloren e Universitetit disponon:<br>▪ Rregulloren e DHAGJ;<br>▪ Misonin e Programit të Studimit;<br>▪ Rregulloren e programit të studimit Bachelor;<br>▪ Planin mësimor të programit të studimit Bachelor;<br>▪ Programet (syllabuset) e lëndëve mësimore;<br>▪ Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar;<br>▪ Manual i përdorimit të diplomes;<br>▪ Model diplome;<br>▪ Suplementi i diplomës;<br>▪ Struktura mësimore 2022-2023;<br>▪ Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit.<br>**[EVIDENCA I.1.** Statuti i UGJ, Neni 65]<br>**[EVIDENCA I.2.** Rregullore e UGJ, Nenet 48, 66]<br>**[EVIDENCA I.20.** Rregullore e FESHSH]<br>**[EVIDENCA I.10.** Rregullore e programit të studimit]<br>**[ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE** - Tabela 10 Plani mësimor]<br>**[EVIDENCA II.2.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2020-2021]<br>**[EVIDENCA II.3.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2021-2022]<br>**[EVIDENCA II.4.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2022-2023]<br>**[EVIDENCA II.16.** Rregullore për format e zhvillimit të provimeve 2020-2021]<br>**[EVIDENCA II.17.** Program i provimit të përgjithshëm përfundimtar]<br>**[EVIDENCA II.18.** Miratimi i fushave të studimit për punimin e diplomës]<br>**[EVIDENCA II.19.** Shtojcat e Rregullores së studimeve në UGJ mbi tezën e diplomës]<br>**[EVIDENCA II.20.** Suplementi i Diplomës]<br>**[EVIDENCA II.8.** Planifikimi i strukturës mësimore të vitit akademik]<br>**[ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE-** Tabelat 6 Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit] |

Adresa: "Rruga Studenti"
"Lagjia 18 Shtatori", Gjirokastër 6001
Tel.: +355 (04) 222-43423
Email: dekanifeshsh@uogj.edu.al
Website : https://uogj.edu.al/

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit. | Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i mëposhtëm:<br>▪ Format e veprimtarive mësimore, numri i javëve mësimore sipas semestrave, numri total i provimeve sipas semestrave;<br>▪ Ndarjen e lëndëve mësimore sipas viteve dhe semestrave;<br>▪ Ndarjen e lëndëve mësimore sipas aktiviteteve formuese;<br>▪ Ngarkesën në kredite, numrin total të orëve, numrin e orëve në auditor dhe jashtë auditorit dhe orëve në javë;<br>▪ Komponentët mësimorë për secilën lëndë;<br>▪ Formën e vlerësimit.<br>[**ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE** - Tabelat 9 Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E)] |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | Pranimi i studentëve në këtë program studimi është kryer në zbatim të kuadrit ligjor.<br>Rregullorja e UGj, rregullorja e studimeve, rregullorja e FESHSH dhe DHAGJ përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.<br>Çdo vit akademik, Njësitë bazë përcjellin për miratim propozimet mbi kriteret dhe kuotat e pranimit të studentëve në ciklin e parë të studimit, kuotat dhe kriteret e transferimit të studentëve në UGJ, në funksion të kapaciteteve pritëse dhe akademike.<br>[**EVIDENCA II.21.** Miratimi i kritereve 2021-2022 dhe kuotave 2020-2021]<br>[**EVIDENCA II.22.** Miratimi i kritereve 2022-2023 dhe kuotave 2021-2022]<br>[**EVIDENCA II.23.** Miratimi i kritereve 2023-2024 dhe kuotave 2022-2023]<br>[**EVIDENCA II.24.** Miratimi i kritereve 2024-2025 dhe kuotave 2023-2024] |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (*syllabuset*) të cilat kanë gjithë elementet e nevojshëm në përputhje me formatin e përcaktuar në VKM Nr.41, datë 24.01.2018 *"Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë"*, VKM Nr.879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave, *"Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit te Lartë"* dhe Vendimin Nr.185, datë 25.03.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, *"Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë"*, të Ndryshuar.<br>Syllabuse përgatiten nga titullari i lëndës/lëndëve në përputhje me formatet e miratuara që përmbajnë: titullari/pedagogu i lëndës, ngarkesa (*numri i krediteve, numri i orëve mësimore në klasë, leksion/seminar, praktika etj.*), tipologjia e lëndës, viti akademik/semestri kur zhvillohet, lloji i lëndës (*e detyrueshme ose me zgjedhje*), programi i studimit ku ofrohet kjo lëndë, kodi i lëndës dhe adresa elektronike e titullarit/pedagogut të lëndës, temat që përfshihen, mënyra e kontrollit të dijes (frekuentimi dhe format e kontrollit të vazhdueshëm të dijeve), literaturë bazë e detyrueshme dhe e rekomanduar.<br>Pedagogu e depoziton programin lëndor (*syllabusin*) të miratuar në fillim të vitit akademik, në Njësinë bazë të cilin ua paraqet studentëve në fillim të semestrit kur zhvillohet lënda.<br>[**EVIDENCA II.2.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2020-2021]<br>[**EVIDENCA II.3.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2021-2022]<br>[**EVIDENCA II.4.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2022-2023] |

Adresa: "Rruga Studenti"
"Lagjja 18 Shtatori", Gjirokastër 6001
Tel : +355 (04) 222-43423
Website : https://uogj.edu.al/
Email: dekanifeshsh@uogj.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPERISE UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTER

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë. | Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë. Këto përmirësime reflektohen në përmirësimin e përmbajtjes, literaturës, metodologjisë etj, dhe kurrikulën duke sugjeruar ndryshime në funksion të përmirësimit të saj apo përshtatjeve me ndryshimet ligjore. Këto kryhen përmes analizës vjetore të DHAGJ, diskutimit dhe miratimit në këtë departament. Ndryshimet e propozuara kalojnë për miratim në Senatin Akademik dhe i përcillen për njoftim MAS.<br>Ndryshimet më të mëdha program i studimit i ka pësuar me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 80/2015, "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", bazuar në nenin 71 dhe 73 për organizimin e programeve të studimit.<br>**[EVIDENCA II.14.** Riorganizimi i planit mësimor 2018-2021]<br>**[EVIDENCA II.15.** Riorganizimi i planit mësimor 2021-2022] |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.4**<br>**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. | Programi "Bachelor" në Histori-Gjeografi, është hartuar dhe emërtuar në mënyrë të tillë që u shërben studentëve për të thelluar dijet e tyre teorike dhe praktike në fusha të Historisë dhe Gjeografisë per t'ju përgjigjur më së miri kërkesave të tregut të punës.<br>Programi i studimit ka të përcaktuar qartë emërtimin, përmbajtjen e veprimtarive, shpërndarjen e lëndëve, duke grupuar lëndët sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 41, datë 24.01.2018, "*Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë*", Vendimit Nr. 879, datë 18.12.2019 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë*" dhe Vendimit Nr. 185, datë 25.03.2021 Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41, datë 24.1.2018, "*Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë*", të Ndryshuar, në:<br>A. LËNDË BAZË të programit të studimit, që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme (*15-20% e totalit të krediteve të këtij programi, ose 27-36 kredite/ ECTS*). Në planin mësimor janë 7 lëndë, në total 36 kredite/ECTS në programin aktual.<br>B. LËNDË KARAKTERIZUESE, që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik, sipas karakteristikave të tij (*50-55% e totalit të krediteve të këtij program, ose 90 – 99 kredite*). Në planin mësimor janë përcaktuar 16 lëndë, në total 96 kredite/ECTS në programin aktual. |

| | |
|---|---|
| | C. LËNDË NDËRDISIPLINORE DHE/OSE INTEGRUESE në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje. (*12-15% e totalit të krediteve të këtij program, ose 21.6- 27 kredite/ ECTS*). Në këtë kategori (në të tre vitet), në planin mësimor janë përcaktuar 10 lëndë, në total 25 kredite/ECTS. Në rubrikën Lëndë me Zgjedhje të kësaj kategorie, studenti duhet të zgjedhë 2 (një) lëndë me nga 3 (tre) kredite/ECTS secila.<br>D. LËNDË PLOTËSUESE - gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale (*të cilat përbëjnë 10 - 15 % të totalit të krediteve të programit të studimit bachelor, ose 18-27* kredite/ECTS). Në këtë kategori (*në të tre vitet*), në planin mësimor janë përcaktuar 5 lëndë, në total 17 kredite/ECTS të programit aktual.<br>E. DETYRIMET PËRMBYLLËSE, të cilat lidhen me përgatitjen për provimin e diplomës apo tezës së diplomës (*3 - 5% e totalit të krediteve të këtij programi, ose 5.4 – 9 kredite ECTS*). Në programin aktual kredite.<br>Ndarja në kategori e veprimtarive formuese, shpërndarja e lëndëve mundëson njohuritë dhe aftësië e nevojshme te cilat do tu shërbejne qoftë si bazë për të vazhduar kualifikimin e mëtejshëm në ciklin e dytë dhe të tretë te studimeve.<br>**[ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE –** Tabelat 9 Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E)**]**<br>**[EVIDENCA II.25.** Plani vjetor i Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit 2022-2023**]**<br>**[EVIDENCA II.26.** Procedurë e gjurmimit të studentëve**]**<br>**[EVIDENCA II.27.** Panairi Work & Study 2022**]**<br>**[EVIDENCA II.28.** Panairi Work & Study 2023**]**<br>**[ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE –** Tabela 23 Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve] |
| **Kriteri 2.** Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit. | Lëndët dhe shpërndarja e tyre në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është bërë duke patur parasysh vështirësinë e konceptimit të tyre, hierarkinë e formimit të koncepteve si dhe ndërvarësinë e lëndëve me njëra-tjetrën. Raportet leksion/seminar/laborator, rezultatet e të nxënit, dhe format e kontrollit të dijeve të pasqyruara në programet e lëndëve mundësojnë realizimin e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.<br>**[ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE –** Tabelat 9 Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E)**]**<br>**[EVIDENCA II.2.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2020-2021**]**<br>**[EVIDENCA II.3.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2021-2022**]**<br>**[EVIDENCA II.4.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2022-2023**]** |
| **Kriteri 3.** Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. | Organizimi i programit të studimit është hartuar dhe rishikuar në referencë të programeve të ngjashme kombëtare/ndërkombëtare dhe në bazë të Sistemit Europian të Transferimit dhe Mbledhjes së Krediteve (ECTS).<br>Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, raporti teori praktikë, janë në përputhje me profilin e Programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme kombëtare / ndërkombëtare.<br>Kurrikula e programit të studimeve është organizuar në formë të tillë që studenti të ketë një ngarkesë të njëjtë përgjatë semestrave, mesatarisht 30 kredite për semestër. Raporti i orëve është në pjesën më të madhe 2/2 (2 orë |

| | |
|---|---|
| | leksion dhe 2 orë seminar) apo 2/1/1 (2 orë leksion 1 orë seminar) duke i dhënë rëndësi rritjes së aftësive të studentëve në ushtrimin dhe aplikimin e njohurive teorike të marra në përputhje me profilin e programit. Ngarkesa në kredite për çdo vit akademik është 60 ECTS, një praktikë kjo e njëjtë me programe të ngjashme ndërkombëtare.<br>**[ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE** – Tabelat 9 Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E)]<br>**[EVIDENCA II.2.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2020-2021]<br>**[EVIDENCA II.3.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2021-2022]<br>**[EVIDENCA II.4.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2022-2023] |
| **Kriteri 4.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | Për hartimin e këtij programi studimi sipas kritereve/kërkesave ligjore, janë mbajtur parasysh nevojat për kombinim të aspektit teorik me atë praktik, për të arritur objektivat e programit. *(Elbasani)*<br>Objektivat e dispilinave, ruajnë një përqindje të krediteve që përcaktojnë ngarkesën e secilës lëndë, bazuar në VKM Nr. 41, datë 24.1.2018:<br>A. LËNDË BAZË - përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme (*15-20% e totalit të krediteve të këtij programi, ose 27-36 kredite/ ECTS*).<br>B. LËNDË KARAKTERIZUESE - formim specifik, sipas karakteristikave të tij (*50-55% e totalit të krediteve të këtij program, ose 90 – 99 kredite*).<br>C. LËNDË NDËRDISIPLINORE DHE/OSE INTEGRUESE - grupe disiplinash, të ngjashme/integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje. (*12-15% e totalit të krediteve të këtij program, ose 21.6- 27 kredite/ ECTS*).<br>D. LËNDË PLOTËSUESE - nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (*të cilat përbëjnë 10 - 15 % të totalit të krediteve të programit të studimit bachelor, ose 18-27* kredite/ECTS).<br>E. DETYRIMET PËRMBYLLËSE, të cilat lidhen me përgatitjen për provimin e diplomës apo tezës së diplomës *(3 - 5% e totalit të krediteve të këtij programi, ose 5.4 – 9 kredite ECTS*).<br>Në programin e studimeve peshën më të madhe e kanë lëndët karakterizuese që i përgjigjen pjesës më të madhe të kompetencave që synon programi, në formimin e specialistëve në fushat e historisë e gjeografisë.<br>Konceptimi dhe ndarja mes veprimtarive formuese synon që studentët të kenë mundësi mobiliteti, të konkurojnë dhe të përshtaten denjësisht jo vetëm në kushtet e tregut vendës, por edhe më gjërë, siç përcaktohet edhe në dokumentat e hartuar nga UE dhe rregulloret e brendshme.<br>Përmes njohurive që jepen në lëndë sipas ndarjes në veprimtari të ndryshme formuese, synohet ofrimi në tregun e punës të profesionistëve të aftë dhe të pajisur me njohuritë më të përditësuara jo vetëm nga ana teorike, por me një vëmendje të veçantë në aspektet praktike dhe analitike për zhvillimin sa më profesional të studimeve dhe reflektimeve historike dhe gjeografike.<br>**[ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE** – Tabelat 9 Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E)] |
| **Kriteri 5.** Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke | Në fillim të çdo viti akademik, përgatitet gjithë dokumentacioni zyrtar që duhet të ketë Njësia bazë. Titullari i lëndës depoziton pranë Njësinë bazë programin lëndor (*syllabusin*) të miratuar. Modeli i përdorur për hartimin e syllabus-eve, në programin e studimit Bachelor në Histori-Gjeografi përmban të gjithë elementet sipas përcaktimeve VKM Nr. 41, duke filluar |

Adresa: "Rruga Studenti"
"Lagjja 18 Shtatori", Gjirokastër 6001
Tel : +355 (04) 222-43428
Email: dekanatifeshsh@uogj.edu.al
Website : https://uogj.edu.al/

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| | |
|---|---|
| përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit. | me pasqyrën informative të lëndës, rezultatet e të nxënit, konceptet themelore, temat e detajuara të lëndës, format e kontrollit të dijeve, frekuentimi, kontrolli i vazhdueshëm, literatura. Pjesa e literaturës në çdo syllabus përbëhet nga literaturë bazë e detyrueshme dhe literatura e rekomanduar. Botimet e reja të fushës së studimit, rezultatet e punës shkencore, integrohen me koncepte e lëndëve të programit. Literatura e detyrueshme dhe ajo e rekomanduar synohet të jetë bashkëkohore.<br>[Vendimi Nr. 41, datë 24.01.2018 "*Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë*": Pika 2.8 dhe Shtojca Nr.2]<br>DHAGJ ka miratuar procedurën e miratimit të syllabusit: titullari i lëndës depoziton pranë Njësinë bazë programin lëndor (*syllabusin*). Në mbledhjen e DHAGJ diskutohet/miratohet përmbajtjen e syllabusit (*elementeve*) si dhe literaturën e përditësuar bazë të detyrueshme dhe të rekomanduar. Këto u bëhen të ditur studentëve me fillimin vitit akademik.<br>[**EVIDENCA I.2.** Rregullore e UGJ, Neni 19, pika 2/b]<br>[**EVIDENCA I.9.** Rregullore e studimeve në UGJ, Neni 26 pika 2]<br>[**EVIDENCA I.20.** Rregullore e FESHSH, Neni 22]<br>[**EVIDENCA II.29.** Miratimi i teksteve mësimore bazë dhe programeve lëndore]<br>[**EVIDENCA II.30.** Procedurë e miratimit të një syllabusi në Departament] |
| **Kriteri 6.** Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. | Përmbajtja e programit të studimit garanton dhe është në përputhje të plotë me përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara të shprehura qartë në qëllimet dhe objektivat e çdo lënde. Lëndët dhe shpërndarja e tyre në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është bërë duke patur parasysh vështirësinë e konceptimit të tyre, hierarkinë e formimit të koncepteve si dhe ndërvarësinë e lëndëve me njëra tjetrën. Raportet leksion/seminar/laborator, rezultatet e të nxënit, dhe format e kontrollit të dijeve të pasqyruara në programet e lëndëve mundësojnë realizimin e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit. Në vitin e dytë dhe të tretë, ata thellojnë njohuritë me lëndë të natyrës karakterizuese të ndërthurura me kategoritë e tjera. Nëpërmjet kësaj shpërndarjeje iu jepet mundësia të zgjerojnë në mënyrë graduale njohuritë e përgjithshme, duke përfituar njohuri karakterizuese të programit, të cilat merren gradualisht, të kombinuara me kategoritë e tjera. Shpërndarja e lëndëve në kurrikula është menduar në këtë mënyrë, që nga ana tjetër të lehtësojë arritjen e objektivave formuese të programit të studimit.<br>[**ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE** - Tabelat 9 Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E)]<br>[**EVIDENCA II.20.** Suplementi i Diplomës]<br>[**EVIDENCA I.11.** Plani strategjik i zhvillimit të Departamentit 2020-2025]<br>[**EVIDENCA I.12.** Plani i zhvillimit të Departamentit 2021-2026] |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | Përmbajta e programit i shërben studentëve për thellimin e njohurive dhe krijimin e kushteve të duhura për një kompetencë të nevojshme në të ardhmen, kur ata të ushtrojnë profesionin e tyre (ciklit të dytë). Përmbajtja e programit iu mundëson studentëve vijimin e mëtejshëm të studimeve në programet e ciklit të dytë të studimit pranë UGJ-së ose Master profesional/Master i Shkencave pranë Universiteteve të tjera publike dhe jopublike. Në funksion të sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit operon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), e cila organizon dhe analizon pyetësorët e studentëve në fund të semestrit. Procedura e përmirësimit të programeve është ajo e analizimit të |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | pyetësorëve, evidentimi i problematikave, dërgimi i tyre në Departamentin përkatës, të cilat diskutohen në mbledhjen e rradhës.<br>**[ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE –** Tabela 23 Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve]<br>**[EVIDENCA II.27.** Panairi Work & Study 2022]<br>**[EVIDENCA II.28.** Panairi Work & Study 2023]<br>**[EVIDENCA II.31.** Sondazhi Kombëtar i Studentëve Mars-Shtator 2022]<br>**[EVIDENCA II.32.** Përshtatshmëria e programeve të studimit të ofruara nga UGJ] | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi II.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës. | Politikat e zhvillimit të DHAGJ rrjedhin nga politikat e zhvillimit të UGJ, të cilat janë hartuar në përputhje me strategjinë e zhvillimin kombëtar dhe nevojat e tregut të punës. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, DHAGJ në bashkëpunim me Zyrën Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, (ZKKA) pranë UGJ është pjesëmarrës dhe promovues i programeve të studimit në evente të ndryshme, zhvilluar me maturantë, studentë dhe aktorë të tjerë nga tregu i punës, duke ndarë eksperiencat, konsultuar dhe marrë parasysh propozimet e tyre.<br>**[EVIDENCA II.27.** Panairi Work & Study 2022]<br>**[EVIDENCA II.28.** Panairi Work & Study 2023]<br>**[EVIDENCA II.25.** Plani vjetor i Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit 2022-2023]<br>**[EVIDENCA II.26.** Procedurë e gjurmimit të studentëve]<br>**[ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE -** Tabela 23 Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve]<br>Ndryshimet e mundshme në kurikulën e këtij programi studimi janë pjesë e një debati shkencor në nivel Departamenti, në mbledhjet e tij, të cilët pasqyrojnë filozofinë e DAHGJ, për t'u ofruar studentëve marrjen e ekspertizës më të mirë të profesorëve të Departamentit, të personelit të ftuar (*profesorëve*) të UT dhe qendrave studimore dhe akademike në Shqipëri dhe partnere jashtë vendit (bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit).<br>Gjithashtu edhe eksperiencat, njohuritë dhe aftësitë e përfituara nëpërmjet trajnimeve dhe pjesëmarrjeve në projekte (KA1 & KA2), pjesëmarrja në aktivitete shkencore të personelit akademik të DHAGJ, bashkëpunimi me UT (*Departamentet e Historisë dhe Gjeografisë*), synojnë në përmirësimin e përmbajtjes dhe ecurisë së programit të studimit.<br>**[EVIDENCA II.33.** Propozime dhe kërkesa për emërimin e personelit akademik]<br>**[EVIDENCA II.34.** Procedurë e rekrutimit të stafit PAE]<br>**[EVIDENCA II.35.** Procedurë e rekrutimit të stafit PAK]<br>**[EVIDENCA I.33.** Lista e mobiliteteve]<br>**[EVIDENCA I.34.** Lista e leksioneve të hapura]<br>**[EVIDENCA I.31.** Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit]<br>**[EVIDENCA II.36.** Anëtarësime në Rrjete Ndërkombëtare] |

Adresa: "Rruga Studenti"
"Lagjja 18 Shtatori", Gjirokastër 6001
Tel : +355 (04) 222-43423
Email: dekanifeshsh@uogj.edu.al
Website : https://uogj.edu.al/

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM CABEJ" GJIROKASTER

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. | UGJ nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre. Studentët janë të angazhuar në Senatin Akademik të UGJ-së, janë të organizuar në Këshillin Studentor të UGJ, dhe kanë Statutin e funksionimit të tyre.<br>[**EVIDENCA II.37.** Rregullore e Senatit Akademik]<br>[**EVIDENCA II.38.** Lista e anëtarëve të Senatit Akademik]<br>[**EVIDENCA II.39.** Lista e përfaqësuesve të Këshillit Studentor të UGJ]<br>[**EVIDENCA II.40.** Statuti i Këshillit Studentor]<br>Nëpermjet Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, UGJ mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar për përmirësimin e programit të studimit.<br>[**EVIDENCA II.32.** Përshtatshmëria e programeve të studimit të ofruara nga UGJ] |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private. | DHAGJ përmirëson, përditëson dhe përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit, në fusha të ndryshme, në bashkëpunim me institucione publike e private.<br>UGJ/FESHSH kanë nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me partnerë të besueshëm kombëtarë dhe ndërkombëtarë si dhe me aktorë të sektorit publik dhe atij privat. Përfshirja e stafit në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, në aktivitete dhe veprimtari studimore shkencore, në aktivitete dhe takime me personalitete të fushës, etj., ka bërë të mundur që DHAGJ të marrë në konsideratë propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve, për të përmirësuar përmbajtjen dhe modulet e këtij programi studimi, me qëllimin rritjen e mundësive të punësimit të studentëve.<br>Pjesëmarrja dhe promovimi i programit të studimit në aktivitete dhe evente të zhvilluara në bashkëpunim me maturantët, studentët dhe aktorë të tjerë nga tregu i punës (*duke ndarë eksperiencat, konsultuar dhe marrë parasysh propozimet e tyre*), anëtarësimi në rrjete ndërkombëtare akademike etj., ka shërbyer si një mundësi e duhur në përmirësimin/përshtatjen e programit të studimit me zhvillimet e fundit.<br>[**EVIDENCA II.41.** Vendim i SA mbi zhvillimin e lëndës me zgjedhje Shkrim dhe menaxhim projektesh]<br>[**EVIDENCA I.31.** Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit]<br>[**EVIDENCA I.34.** Lista e leksioneve të hapura]<br>[**EVIDENCA II.36.** Anëtarësime në Rrjete Ndërkombëtare]<br>[**EVIDENCA I.32.** Lista e projekteve] |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

Adresa: "Rruga Studenti"
"Lagjja 18 Shtatori", Gjirokastër 6001
Tel : +355 (04) 222-43423
Email: dekanifeshsh@uogj.edu.al
Website : https://uogj.edu.al/

REPUBLIKA E SHQIPERISE UNIVERSITETI "EQREM CABEJ" GJIROKASTER

## III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| **Standardi III.1** **Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | Rregullorja e UGJ, Rregullorja e studimeve në UGJ, Rregullorja e FESHSH, përcaktojnë se format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve dhe njohurive janë leksionet, seminaret, ushtrimet, laboratorët, format e kontrollit të vazhdueshëm dhe seancat e praktikave mësimore, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni, të cilat reflektohen në planin mësimor si dhe në programet lëndore (*syllabuset*) e programit të studimit.<br>**[EVIDENCA I.1.** Statuti i UGJ, Neni 8, Neni 74]<br>**[EVIDENCA I.2.** Rregullore e UGj, Neni 30, Neni 70]<br>**[EVIDENCA I.9.** Rregullore e studimeve në UGJ, Neni 22]<br>**[EVIDENCA I.20.** Rregullore e FESHSH, Neni 19 pika 4]<br>**[EVIDENCA I.21.** Rregullore e Njësisë bazë, Neni 27 pika 1]<br>**[EVIDENCA I.10.** Rregullore e programit të studimit, Neni 26 pika 1]<br>**[EVIDENCA II.2.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2020-2021]<br>**[EVIDENCA II.3.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2021-2022]<br>**[EVIDENCA II.4.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2022-2023]<br>Gjatë vitit akademik 2020-2021, programi i studimit ka funksionuar me planin mësimor 2018-2021, në zbatim të Vendimit të Senatit Akademik Nr. 16, datë 23.02.2018, Nr. 1345 Prot. Vendimit i bashkëlidhen propozimi i ardhur nga Njësia bazë dhe i miratuar nga Njësia kryesore.<br>**[EVIDENCA II.14.** Riorganizimi i planit mësimor 2018-2021]<br>Gjatë vitit akademik 2021-2022, viti I (i parë) funksionoi me planin e ri mësimor 2021-2022, në zbatim të Vendimit të Senatit Akademik Nr. 37, datë 05.11.2020, Nr. 1358 Prot (*Vendimit i bashkëlidhen propozimi i ardhur nga Njësia bazë dhe i miratuar nga Njësia kryesore*), ndërsa viti II (i dytë) dhe viti III (i tretë) vazhduan me planin mësimor 2018-2021.<br>**[EVIDENCA II.15.** Riorganizimi i planit mësimor 2021-2022]<br>Gjatë vitit akademik 2022-2023, viti I (i parë) dhe viti II (i dytë) vazhduan me planin e ri mësimor 2021-2022, ndërsa viti III (i tretë) me planin mësimor 2018-2021.<br>**[ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE** - Tabelat 9 Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E)]<br>Kurrikula e programit të studimit reflekton një raport gati të drejtë mes teori/praktikë dhe orëve të studimit në auditor/individual (2029/2471 orë).<br>**[ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE** - Tabelat 13 Ngarkesa totale në auditor e studentëve për Format e mësimdhënies në programin e studimit, për secilin program]<br>**[ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE** - Tabelat 10 Plani mësimor] |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. | Personeli akademik i angazhuar në këtë program, i përgjigjet larmisë së nevojave të studentëve, duke ofruar metoda alternative të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Bazuar në Rregulloren e programit të studimit, mësimdhënia përfshin metoda didaktike inovative, nëpërmjet përdorimit të teknologjive të informacionit dhe komunikimit në mësimdhënie, duke pasuruar metodat tradicionale. |

<table>
<tr><td></td><td>[EVIDENCA I.10. Rregullore e programit të studimit, Neni 13 pika 1]<br>[EVIDENCA III.1. Udhëzues institucional mbi metodat inovative në mësimdhënie]<br>Gjatë periudhës së pandemisë Covid-19, UGJ ofroi alternativën on-line të mësimdhënies dhe mësimnxënies nëpërmjet platformave elektronike të mësimit në distancë, Classroom, Edumeet, Microsoft Office 365 dhe Microsoft Teams.<br>Në Virtual University v.uni, mësimi on-line u zhvillua në platformat eduMEET, moodle, v.meet.<br>Për një mësimdhënie sa më efektive, UGJ krijoi kushtet e nevojshme për trajnimin dhe aksesin e studentëve dhe personelit akademik në këto platforma, nëpërmjet mbështetjes, me manuale përdorimi nga Zyra e Teknologjisë së Informacionit.<br>[EVIDENCA III.2. Format e zhvillimit të procesit mësimor 2020-2021]<br>[EVIDENCA III.3. Implementimi i platformës së mësimit online CLASSROOM]<br>[EVIDENCA III.4. Manual i platformës CLASSROOM]<br>[EVIDENCA III.5. Implementimi i platformave Moodle; Vuni; Edumeet]<br>[EVIDENCA III.6. Manual i platformës MOODLE]<br>[EVIDENCA III.7. Manual i platformës EDUMEET]<br>[EVIDENCA III.8. Aktivizimi i platformës Office 365]<br>[https://uogj.edu.al/platforma-office-365-dhe-teams-per-mesimin-online/]<br>[EVIDENCA III.9. Manual i përdorimit të platformës OFFICE 365 dhe TEAMS për mësimin on-line, për personelin akademik]<br>[http://www.uogj.edu.al/wp-content/uploads/Test/upload/Full%20Guide%20Teachers.pdf]<br>[EVIDENCA III.10. Manual i përdorimit të platformës OFFICE 365 dhe TEAMS për mësimin on-line, për studentët]<br>[http://www.uogj.edu.al/wp-content/uploads/Test/upload/Full%20Guide%20Students.pdf]<br>[EVIDENCA II.16. Rregullore për format e zhvillimit të provimeve 2020-2021]<br>Gjatë viteve të pandemisë janë organizuar edhe konsultime shtesë me studentët, me presence në auditor, sipas një kalendari të mirëpërcaktuar.<br>[EVIDENCA III.11. Procedurë për mbylljen e vitit akademik 2020-2021]<br>Gjithashtu, programi i studimit ka të përfshirë në planin mësimor, veprimtaritë formuese "Lëndë me zgjedhje", veprimatri alternative të kurrikulës që lejojnë studentin të zgjedhë një lëndë nga një grup lëndësh. [ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE - Tabelat 10 Plani mësimor]</td></tr>
<tr><td>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</td><td>UGJ mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit nëpërmjet:<br>▪ përmirësimit të infrastrukturës së mësimdhënies, duke ofruar auditore të pajisura me teknologji bashkëkohore të mësimdhënies;<br>▪ modernizimit të bazës laboratorike dhe mbajtjes së saj në gadishmëri për zhvillimin e aspekteve praktike të procesit mësimor;<br>[EVIDENCA III.12. Laboratori i Arkeologjisë]<br>[EVIDENCA III.13. Laboratori i Gjeografisë]<br>[EVIDENCA III.14. Projekte në bashkëfinancim me AKSHI (GIS dhe ASPIC)]<br>▪ krijimit të oportuniteteve për stafin akademik për zhvillimin e kapaciteteve didaktike dhe kërkimore-shkencore nëpërmjet mobiliteteve të ndryshme në institucionet e arsimit të lartë jashtë vendit si dhe pjesëmarrjes në trajnime dhe workshop-e, në kuadrin e projekteve me partnerë të huaj, për të përsosur metodat e mësimdhënies;<br>[EVIDENCA I.31. Lista e projekteve]</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| | **[EVIDENCA I.32.** Lista e mobiliteteve]<br>▪ hartimit të udhëzuesve për zhvillimin dhe përdorimin e formave dhe metodave të ndryshme inovative të mësimdhënies;<br>**[EVIDENCA III.1.** Udhëzues institucional mbi metodat inovative në mësimdhënie]<br>▪ përdorimit të librarive elektronike (*JSTORE dhe U-Library*) krahas Bibliotekës Qendrore të UGJ, me një fond të pasur literature dhe mjedise të përshtatshme.<br>**[EVIDENCA III.15.** Biblioteka digjitale]<br>**[EVIDENCA III.16.** Manual i Bibliotekës digjitale]<br>[https://ulibrary.rash.al/manual.pdf]<br>**[ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE** – Tabel 17 Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj]<br>Gjatë periudhës 2017-2020, Universiteti "Eqrem Çabej" Gjirokastër, ka qenë partner në projektin ndërkombëtar TEAVET. Bazuar në projektin "*Zhvillimi i kompetencave të mësuesve për një sistem gjithëpërfshirës të zhvillimit professional të mësuesve në Shqipëri (TEAVET-ERASMUS+)*", Universitetet pjesëmarrëse në projekt patën si qëllim koordinimin ndërinstitucional për zhvillimin profesional të mësuesve në sistemin e arsimit parauniversitar, nëpërmjet trajnimeve të mësuesve. Pjesë e këtij projekti kanë qenë dhe personel akademik nga DHAGJ. Gjatë këtij angazhimi të zbatimit të projektit me partner brenda dhe jashtë vendit, personeli akademik pjesmarres u trajnua për përmirësimin e kompetencave didaktike në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, duke përgatitur dhe module trajnimi për zhvillimin e kompetencave të mësuesve për një sistem gjithëpërfshirës të zhvillimit profesional. Këto module të përgatitur edhe nga personeli akademik i DHAGJ u akredituan nga Komisioni i Akreditimit të Programeve/moduleve të Trajnimit (*KAPT*), në bashkëpunim me Institutin e Zhvillimit të Trajnimeve (*sot ASCAP*) në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.<br>**[EVIDENCA III.17.** Projekti TEAVET (Erasmus+)]<br>[http://www.uogj.edu.al/upload/aktivitetet/Projekte%20nderkombetare.pdf] |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | Programi i studimit i përmbush kërkesat ligjore në fuqi përsa i përket kualifikimit të personelit akademik që angazhohet për realizimin e tij.<br>[Ligji Nr. 80/2015, Neni 59, pika 3, 4, 5, 6]<br>**[ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE** – Tabelat 6 Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit]<br>Niveli i kualifikimit të personelit akademik të programit është i duhuri, për shpjegimin e njohurive dhe koncepteve të lëndëve mësimore, reflektuar në shpërndarjen e ngarkesës mësimore.<br>Aktualisht, për vitin akademik 2022-2023, personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi përbëhet nga 9 personel akademik, me kontratë, me kohëzgjatje të pacaktuar si edhe me angazhim me kohë të plotë; 2 (dy) personel akademik, me kontratë, me kohëzgjatje të caktuar si edhe me angazhim me kohë të plotë; 2 (dy) personel akademik, me kontratë, me kohëzgjatje të caktuar si edhe me angazhim me kohë të pjesshme; 5 (pesë) personel akademik i ftuar.<br>**[EVIDENCA III.18.** Europass CV]<br>**[ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE** – Tabelat 4 Ngarkesa totale e personelit akademik të programit "Bachelor" në Histori-Gjeografi në një vit akademik] |

Adresa: "Rruga Studenti"
"Lagjia 18 Shtatori", Gjirokastër 6001
Tel : +355 (04) 222-43423
Website : https://uogj.edu.al/
Email: dekanifeshsh@uogj.edu.al

| | |
|---|---|
| | Personeli akademik i DHAGJ, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit tek studentët mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.<br>Personeli akademik bën përpjekje të vazhdueshme për të përditësuar metodat e ndryshme të mësimdhënies interaktive, që nxisin mendimin kritik, debatin shkencor, lirinë e shprehjes së mendimit, respektimin e mendimit ndryshe, por edhe diskutime me në qendër studentin.<br>[https://www.esri.com], [https://earth.google.com], [https://www.arcgisonline.com]<br>Metodat që përdoren përgjithësisht sipas tipit të veprimtarisë mësimore janë:<br>▪ leksionet, shpjegim i shoqëruar me paraqitje në dërrasë/prezantime të tipit "*PowerPoint*", nëpëmjet videoprojektorëve;<br>▪ seminaret, diskutime interaktive në zgjidhjen e tematikave/çështjeve të shtruara në auditor;<br>▪ praktika në terren, konkretizim i njohurive teorike të marra në auditor.<br>Çdo student merr këshilla dhe konsulta të vazhdueshme, gjatë orës së mësimit/konsultimeve, të përcaktuara nga pedagogu i lëndës.<br>Gjithashtu, studentët mund të komunikojnë me pedagogun e lëndës edhe elektronikisht nëpërmjet email-it institucional.<br>Kompetenca e personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie evidentohet edhe nga rezultatet e pyetësorëve të studentëve, ku mbi 92% e tyre konfirmojnë vlerësimin "*mirë*" dhe "*shumë mirë*", në pyetjet që lidhen me aftësitë e të qënit kompetent në procesin mësimor.<br>[**EVIDENCA III.19.** Procedura e organizimit të pyetësorit studentor 2020-2021]<br>[**EVIDENCA III.20.** Raport i pyetësorit për procesin e mësimit online Prill-Maj 2022] |
| **Kriteri 5.** Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre. | Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sygjerimet e tyre.<br>NJSBC realizon me studentët pyetësorë për vlerësimin e mësimdhënies. Vlerësimet, mendimet dhe sugjerimet e studentëve merren parasysh për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, trajtimit të lëndës, përdorimit të metodave dhe teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies, vlerësimit etj. Gjithashtu, kontrolle të vazhdueshme kryhen nga autoritet drejtuese të institucionit si dhe strukturave që merren me sigurimin e cilësisë dhe performancës në rang UGJ/FESHSH.<br>[**EVIDENCA III.19.** Procedura e organizimit të pyetësorit studentor 2020-2021]<br>[**EVIDENCA III.20.** Raport i pyetësorit për procesin e mësimit online Prill-Maj 2022]<br>[**EVIDENCA II.32.** Përshtatshmëria e programeve të studimit të ofruara nga UGJ] |
| **Kriteri 6.** Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht | Bazuar në Statutin e UGJ, njësitë ndihmëse në funksion të procesit mësimor-kërkimor janë:<br>▪ Sektori i Standarteve të Cilësisë dhe Kurrikulave (SSCK)<br>▪ Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë (SKSHMJ).<br>Këta sektorë, janë pjesë përbërëse e Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmësakademike-Administrative (DSHNA-A), që promovojnë mësimdhënien dhe përmirësimin e vazhdueshëm të saj, koordinojnë dhe bashkërendojnë me Njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, duke mbështetur zhvillimin e metodave të reja innovative, trajnojnë personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja. |


REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja. | **[EVIDENCA III.1.** Udhëzues institucional mbi metodat inovative në mësimdhënie]<br>**[EVIDENCA I.31.** Lista e projekteve]<br>**[EVIDENCA I.32.** Lista e mobiliteteve]<br>UGJ, ka Buletinin e tij shkencor "Kërkime Universitare", në format letër dhe në format elektronik, i pajisur me ISSN: 2226-082X, me botime të personelit akademik të UGJ si dhe nga IAL-të e tjera, brenda dhe jashtë vendit.<br>**[EVIDENCA I.1.** Statuti i UGJ, Neni 74, Neni 84, Neni 94 pika 3, pika 5 gërma d]<br>**[EVIDENCA III.21.** Periodikët e botuar nga UGJ] | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| | |
|---|---|
| **Standardi III.2**<br>**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët. | Kriteret dhe mënyra e testimit, vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në Rregulloren e UGJ, Rregulloren e studimeve në UGJ, Rregulloren e FESHSH, Rregulloren e DHAGJ, Rregulloren e programit të studimit "Bachelor" në Histori-Gjeografi, Programet lëndore si dhe Udhëzimet institucionale.<br>**[EVIDENCA I.2.** Rregullore e UGj, Neni 68, Neni 81, Neni 82, Neni 83]<br>**[EVIDENCA I.9.** Rregullore e studimeve në UGJ, Neni 39, Neni 40, Neni 41, Neni 62, Neni 63, Neni 64]<br>**[EVIDENCA I.20.** Rregullore e FESHSH, Neni 33, Neni 34, Neni 35, Neni 38]<br>**[EVIDENCA I.21.** Rregullore e Njësisë bazë, Neni 26, Neni 28, Neni 30, Neni 31, Neni 32]<br>**[EVIDENCA I.10.** Rregullore e programit të studimit, Neni 16 pika 2]<br>**[EVIDENCA II.2.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2020-2021]<br>**[EVIDENCA II.3.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2021-2022]<br>**[EVIDENCA II.4.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2022-2023]<br>**[EVIDENCA III.22.** Formati i unifikuar i tezës së provimit]<br>**[EVIDENCA III.23.** Marrëveshje bashkëpunimi AADF-UGJ për zbatimin e projektit CleanScore]<br>Rregulloret e mësipërme janë të publikuara në faqen zyrtare web të UGJ, ku studentët mund të informohen në lidhje me kriteret e mënyrat e testimit dhe vlerësimit të njohurive.<br>Një referencë tjetër për të orientuar studentët për çdo pyetje/paqartësi është edhe përgjegjësi i Njësisë bazë apo çdo anëtar i Departamentit. |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Bazuar në Rregulloren e studimeve në UGJ modalitetet e vlerësimit dhe detyrimet e studentit u bëhen të njohura studentëve me fillimin e procesit mësimor dhe janë të parashikuara në syllabuset e lëndëve nga titullari i lëndës. Njëkohësisht personeli akademik vë në theks edhe në metodologjinë e vlerësimit të dijeve, aftësive profesionale e shkencore, dhe kompetencave të fiturara nga studentët në lëndën apo modulin përkatës. Një kujdes i veçantë për informim iu kushtohet studentëve të vitit të parë Bachelor të cilët kërkojnë një orientim më të plotë dhe më të saktë sesi funksionon veprimtaria mësimore në universitet.<br>**[EVIDENCA I.9.** Rregullore e studimeve në UGJ, Neni 39 pika 4, 5]<br>**[EVIDENCA II.2.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2020-2021] |

Adresa: "Rruga Studenti"
"Lagjja 18 Shtatori", Gjirokastër 6001
Tel : +355 (04) 222-48423
Email: dekanifeshsh@uogj.edu.al
Website : https://uogj.edu.al/

| | |
|---|---|
| | **[EVIDENCA II.3.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2021-2022]<br>**[EVIDENCA II.4.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2022-2023]<br>**[ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE** – Tabelat 13 Ngarkesa totale në auditor e studentëve për format e mësimdhënies në programin e studimit, për secilin program] |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | Rregullorja e UGJ, Rregullorja e studimeve në UGJ, Rregullorja e FESHSH, Rregullorja e Njesisë Bazë të Historisë, Antropologjisë dhe Gjeografisë, por edhe Rregullorja e programit të studimit "Bachelor" në Histori-Gjeografi përcaktojnë qartë mënyrat e vlerësimit të studentëve. Në programin lëndor shprehen modalitetet e vlerësimit dhe detyrimet e studentit, të cilat i bëhen të njohura studentëve me fillimin e procesit mësimor. Studentët informohen për vlerësimin, në mënyrë specifike në çdo veprimtari mësimore që ata kryejnë, të tilla si punë praktike, detyra kursi, kontrolle me shkrim. Secila veprimtari vlerësohet në pikë ose notë. Vlerësimi i studentit bazohet në vlerësimin i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuara në programin e lëndës dhe të provimit final. Vlerësimi i vazhduar përfaqëson 20% të vlerësimit përfundimtar.<br>**[EVIDENCA III.24.** Regjistër Pedagogu]<br>**[EVIDENCA I.9.** Rregullore e studimeve në UGJ, Neni 39 pika 5, 6]<br>**[EVIDENCA II.2.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2020-2021]<br>**[EVIDENCA II.3.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2021-2022]<br>**[EVIDENCA II.4.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2022-2023]<br>Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore në përfundim të lëndës zhvillohet me shkrim. Numri i pyetjeve (*pyetje teorike ose ushtrime*) që përmban një tezë e provimit me shkrim varet nga vëllimi i lëndës, numri i leksioneve dhe seminareve etj. Një tezë e provimit me shkrim përmban pyetje teorike dhe/ose ushtrime që vlerësohen në total me 80 pikë. Për çdo pyetje/ushtrim vihen pikët përkatëse, në varësi të karakterit të pyetjes/ushtrimit. Pyetjet përfshijnë në mënyrë tërësore lëndën përkatëse, duke qenë të formuluara qartë, jo me dykuptime, në mënyrë që studenti të jetë në gjendje të bëjë vetëvlerësimin për përgjigjet që ka shkruar.<br>Në rang universiteti/fakulteti është miratuar formati i unifikuar i tezës së provimit, i cili ndërtohet nga 5 (pesë) seksione të natyrës përshkrimore, analizuese, ese, pyetje me alternativa, koncepte etj.<br>**[EVIDENCA III.22.** Formati i unifikuar i tezës së provimit]<br>**[EVIDENCA I.9.** Rregullore e studimeve në UGJ, Neni 39, Neni 40, Neni 44]<br>**[EVIDENCA II.2.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2020-2021]<br>**[EVIDENCA II.3.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2021-2022]<br>**[EVIDENCA II.4.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2022-2023] |
| **Kriteri 4.** Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. | Personeli akademik i DHAGJ-së, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre. Përmirësimi i formave dhe metodave të mësimdhënies synohet jo vetëm nga departamenti në rrugë zyrtare por edhe nga motivimi i personelit akademik për të avancuar në aspektin profesional dhe metodik. NJSBC realizon me studentët pyetësorë për vlerësim. Vlerësimet, mendimet dhe sugjerimet e studentëve merren parasysh për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, trajtimit të lëndës, përdorimit të metodave, vlerësimit etj.<br>**[EVIDENCA III.19.** Procedura e organizimit të pyetësorit studentor 2020-2021]<br>**[EVIDENCA III.20.** Raport i pyetësorit për procesin e mësimit online Prill-Maj 2022] |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | UGJ mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike të përshtatshme dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, me objektivat formuese etj, nëpërmjet:<br>▪ përmirësimit të infrastrukturës së mësimdhënies duke ofruar auditor të pajisur me teknologji bashkëkohore të mësimdhënies;<br>**[EVIDENCA III.25.** Biblioteka e DHAGJ]<br>▪ modernizimit të bazës laboratorike dhe mbajtjes së saj në gadishmëri për zhvillimin e aspekteve praktike të procesit mësimor;<br>**[EVIDENCA III.12.** Laboratori i Arkeologjisë]<br>**[EVIDENCA III.13.** Laboratori i Gjeografisë]<br>**[EVIDENCA III.14.** Projekte në bashkëfinancim me AKSHI (GIS dhe ASPIC)]<br>▪ krijimit të oportuniteteve për stafin akademik për zhvillimin e kapaciteteve didaktike dhe kërkimore shkencore nëpërmjet mobiliteteve të ndryshme në institucionet e arsimit të lartë jashtë vendit si dhe pjesëmarrjes ne trajnime e workshope në kuadrin e projekteve me partnerë të huaj, për të përsosur metodat e mësimdhënies;<br>**[EVIDENCA I.31.** Lista e projekteve]<br>**[EVIDENCA I.32.** Lista e mobiliteteve]<br>▪ Hartimit të udhëzuesve për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme innovative të mësimdhënies.<br>**[EVIDENCA III.1.** Udhëzues institucional mbi metodat inovative në mësimdhënie]<br>**[EVIDENCA III.8.** Aktivizimi i platformës Office 365]<br>**[EVIDENCA III.9.** Manual i përdorimit të platformës OFFICE 365 dhe TEAMS për mësimin *on-line*, për personelin akademik]<br>[http://www.uogj.edu.al/wp-content/uploads/Test/upload/Full%20Guide%20Teachers.pdf]<br>**[EVIDENCA III.10.** Manual i përdorimit të platformës OFFICE 365 dhe TEAMS për mësimin *on-line*, për studentët]<br>[http://www.uogj.edu.al/wp-content/uploads/Test/upload/Full%20Guide%20Students.pdf]<br>**[EVIDENCA III.15.** Biblioteka digjitale]<br>**[EVIDENCA III.16.** Manual i Bibliotekës digjitale]<br>[https://ulibrary.rash.al/manual.pdf]<br>Në programin lëndor të secilës prej lëndëve evidentohen dhe format e metodat e mësimdhënies të cilat inkurajojnë sensin e autonomisë së studentit.<br>**[EVIDENCA II.2.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2020-2021]<br>**[EVIDENCA II.3.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2021-2022]<br>**[EVIDENCA II.4.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2022-2023]<br>Në fokus të procesit mësimor është angazhimi i studentëve nëpërmjet ushtrimeve, punëve laboratorike, detyrave të kursit, literaturës së rekomanduar etj., të cilat nxitin në mënyrë të vazhdueshme autonominë dhe mendimin kritik të studentëve. Përgjatë kohës së punës për këto detyra, studenti mbështetet me udhëzime dhe orientime prej pedagogut të lëndës, si nëpërmjet komunikimit të drejtpërdrejtë gjatë orës së mësimit apo gjatë orarit zyrtar me studentin, por edhe nëpërmjet komunikimit elektronik. Këto forma dhe metoda të mësimdhënies, mbështetur në këto mënyra të komunikimit, ndihmojnë në ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre si dhe duke respektuar rregullat dhe etikën profesionale.<br>**[EVIDENCA III.26.** Kodi i Etikës, Neni 5]<br>Njëkohësisht në planin mësimor të programit për çdo lëndë parashikohen dhe orët e studimit individual të lëndës. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Një sfidë e veçantë ka qenë zhvillimi i procesit mësimor gjatë periudhës së pandemisë. Gjatë kësaj periudhe mësimdhënia është zhvilluar nëpërmjet platformave elektronike të mësimit në distancë, Classroom, Edumeet, Microsoft Office 365 dhe Microsoft Teams.<br>Për një mësimdhënie sa më efektive UGJ krijoi kushtet e nevojshme për aksesim nga ana e studentëve dhe personelit akademik në këto platforma nëpërmjet mbështetjes nga personeli IT i universitetit si dhe ndihmoi me dokumentacionin e nevojshëm teknologjik për përdorimin e këtyre platformave.<br>**[EVIDENCA III.2.** Format e zhvillimit të procesit mësimor 2020-2021]<br>**[EVIDENCA III.3.** Implementimi i platformës së mësimit online CLASSROOM]<br>**[EVIDENCA III.4.** Manual i platformës CLASSROOM]<br>**[EVIDENCA III.5.** Implementimi i platformave Moodle; Vuni; Edumeet]<br>**[EVIDENCA III.6.** Manual i platformës MOODLE]<br>**[EVIDENCA III.7.** Manual i platformës EDUMEET]<br>**[EVIDENCA III.8.** Aktivizimi i platformës Office 365]<br>**[EVIDENCA III.9.** Manual i përdorimit të platformës OFFICE 365 dhe TEAMS për mësimin *on-line*, për personelin akademik]<br>[http://www.uogj.edu.al/wp-content/uploads/Test/upload/Full%20Guide%20Teachers.pdf]<br>**[EVIDENCA III.10.** Manual i përdorimit të platformës OFFICE 365 dhe TEAMS për mësimin *on-line*, për studentët]<br>[http://www.uogj.edu.al/wp-content/uploads/Test/upload/Full%20Guide%20Students.pdf]<br>**[EVIDENCA II.16.** Rregullore për format e zhvillimit të provimeve 2020-2021]<br>**[EVIDENCA III.2.** Format e zhvillimit të procesit mësimor 2020-2021]<br>**[EVIDENCA III.27.** Kalendare provimesh dhe Komisione diplomimi] | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi III.3**<br>**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Rregullorja e studimeve në UGJ, Rregullorja e FESHSH, Rregullorja e DHAGJ, si dhe Rregullorja e programit të studimit të Bachelor në "Histori-Gjeografi", përcaktojnë qartë mënyrat e vlerësimit te studentëve.<br>**[EVIDENCA I.9.** Rregullore e studimeve në UGJ, Neni 39 pika 5, Neni 40, Neni 41]<br>**[EVIDENCA I.20.** Rregullore e FESHSH, Neni 34, pika 1, 2, 3, 4]<br>**[EVIDENCA I.21.** Rregullore e Njësisë bazë, Neni 45, Neni 46, Neni 47]<br>**[EVIDENCA I.10.** Rregullore e programit të studimit, Neni 16]<br>Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar i cili bëhet me notë. Shkalla e përvetësimit të programit lëndor vlerësohet me sistemin prej 10 (dhjetë) notash. Nota më e ulët kaluese në një lëndë është nota 5 (pesë). Në format e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit konvertohet në notë. Personeli akademik në programin lëndor shpreh modalitetet e vlerësimit dhe detyrimet e studentit, të |

| | |
|---|---|
| | cilat i bëhen të njohura studentëve me fillimin e procesit mësimor.<br>Bazuar në Rregulloren e studimeve në UGJ dhe në programin e lëndës vlerësimi përfundimtar i studentit përbëhet nga:<br>▪ Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit i cili përbën 20 % të vlerësimit përfundimtar;<br>▪ Vlerësimi në provim i cili përbën 80 % të vlerësimit përfundimtar.<br>**[EVIDENCA II.2.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2020-2021]<br>**[EVIDENCA II.3.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2021-2022]<br>**[EVIDENCA II.4.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2022-2023]<br>**[EVIDENCA III.22.** Formati i unifikuar i tezës së provimit]<br>Bazuar në Rregulloren e UGJ-së në përfundim të procesit mësimor (në orën e fundit të mësimit) çdo pedagog që ëshrë përgjegjës lënde u komunikon studentëve:<br>▪ Fitimin ose jo të së drejtës për tu futur në provimin e lëndës përkatëse;<br>▪ Rezultatin e vlerësimit të vazhduar.<br>Llogaritja e Vlerësimit përfundimtar bëhet sipas përcaktimeve në Rregulloren e Universitetit.<br>**[EVIDENCA I.2.** Rregullore e UGj, Neni 81 pika 1, Neni 89**]** |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | UGJ zbaton prej disa vitesh edhe sistemin e automatizuar të korrigjimit të provimeve, në sajë të projektit CLEANSCORE të financuar nga AADF.<br>**[EVIDENCA III.23.** Marrëveshje bashkëpunimi AADF-UGJ për zbatimin e projektit CleanScore]<br>Gjatë periudhës së pandemisë "Covid 19", në kohën e mësimit "*on-line*", UGJ ka implementuar testimin përmes platformës elektronike Microsoft Teams, duke garantuar shpejtësi, transparencë, objektivitet dhe informim të menjëhershëm e të shpejtë të vlerësimit të studentëve. Kjo është zbatuar dhe në programin "Bachelor" në Histori-Gjeografi duke kryer me sukses dhe transparencë të plotë vlerësimin e studentëve. Personeli akademik i DHAGJ ka marrë pjesë në trajnimet e organizuar nga UGJ për hartimin e tezës elektronike të provimit, shfaqjen e rezultateve, planifikimin e orarit të provimit online, etj. nëpërmjet platformës Microsoft TEAMS për të siguruar mbarëvajtjen e provimit (*testimit online*).<br>**[EVIDENCA II.16.** Rregullore për format e zhvillimit të provimeve 2020-2021]<br>**[EVIDENCA III.2.** Format e zhvillimit të procesit mësimor 2020-2021]<br>**[EVIDENCA III.27.** Kalendare provimesh dhe Komisione diplomimi]<br>**[EVIDENCA III.8.** Aktivizimi i platformës Office 365]<br>**[EVIDENCA III.9.** Manual i përdorimit të platformës OFFICE 365 dhe TEAMS për mësimin *on-line*, për personelin akademik]<br>[http://www.uogj.edu.al/wp-content/uploads/Test/upload/Full%20Guide%20Teachers.pdf]<br>**[EVIDENCA III.10.** Manual i përdorimit të platformës OFFICE 365 dhe TEAMS për mësimin *on-line*, për studentët]<br>[http://www.uogj.edu.al/wp-content/uploads/Test/upload/Full%20Guide%20Students.pdf] |
| **Kriteri 3.** Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. | Bazuar në Rregulloren e studimeve në UGJ dhe në programin e lëndës vlerësimi përfundimtar i studentit përbëhet nga:<br>▪ Vlerësimi i vazhduar gjatë vitit, i cili përbën 20 % të vlerësimit përfundimtar.<br>▪ Vlerësimi në provim i cili përbën 80 % të vlerësimit përfundimtar.<br>**[EVIDENCA I.9.** Rregullore e studimeve në UGJ, Neni 39**]**<br>**[EVIDENCA II.2.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2020-2021**]** |

| | |
|---|---|
| | **[EVIDENCA II.3.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2021-2022]<br>**[EVIDENCA II.4.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2022-2023]<br>**[EVIDENCA III.22.** Formati i unifikuar i tezës së provimit]<br>Bazuar në Rregulloren e UGJ në përfundim të procesit mësimor (*në orën e fundit të mësimit*) çdo pedagog që është përgjegjës lënde u komunikon studentëve:<br>▪ fitimin ose jo të së drejtës për tu futur në provimin e lëndës përkatëse;<br>▪ rezultatin e vlerësimit të vazhduar.<br>Llogaritja e Vlerësimit përfundimtar bëhet sipas përcaktimeve në Rregulloren e UGJ.<br>**[EVIDENCA I.2.** Rregullore e UGj, Neni 81 pika 1, Neni 89] |
| **Kriteri 4.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Vlerësimi i njohurive të studentëve kryhet nëpërmjet fazave të ndryshme të kontrollit gjatë semestrit (*teste, provimi i ndërmjetëm, detyrë kursi, provim final*). Korrigjimi i provimit me shkrim bëhet nga komisioni i provimit.<br>Njohja me rezultatet paraprake të provimit u bëhet me dije studentëve nëpërmjet publikimit *on-line* në librezën e tyre elektronike (*në sistemin ESSE3, tashmë në sistemin Pitagora*) ose pranë DHAGJ-së brenda 6 diteve nga data e zhvillimit të tij.<br>**[EVIDENCA I.2.** Rregullore e UGj, Neni 90]<br>Pas shpalljes së rezultateve, studentëve u jepet e drejta që të rishikojnë individualisht tezat e korrigjuara prej pedagogut, duke parë në këtë mënyrë vlerësimin për secilën përgjigje të tyre (*të shoqëruara me komente/feedback, këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen*) dhe të paraqesin ankesat e tyre eventuale në lidhje me vlerësimin nga ana e pedagogut. Kjo e drejtë e studentëve garantohet në Rregulloren e studimeve në UGJ.<br>**[EVIDENCA I.9.** Rregullore e studimeve në UGJ, Neni 46]<br>Deri 8 (*tetë*) ditë nga data e zhvillimit të provimit pedagogu gjeneron, publikon online dhe dorëzon në sekretarinë mësimore pasqyrën e rezultateve përfundimtare të provimit, në rastet kur nuk ka proces ankimimi për rezultatin e provimit nga studenti. |
| **Kriteri 5.** Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | Personeli akademik i DHAGJ ndjekin rregulla strikte për të evituar çdo formë të plagjaturës, apo kopjimit në provime dhe detyra, për studentët që frekuentojnë programin e studimit. Ata ndjekin dhe zbatojnë rregullat e provimeve të përcaktuara në rregulloren e studimeve në UGJ, në Rregulloren e UGJ, në Kodin e Etikës dhe në syllabuset e çdo lënde nëpërmjet "*Vërejtjeve përfundimtare nga pedagogu i lëndës*", hapësira ku pedagogu parashtron mendime, rekomandime, vërejtje, kufizime, rezerva që lidhen me zhvillimin e lëndës në fjalë gjatë vitit akademik.<br>**[EVIDENCA I.9.** Rregullore e studimeve në UGJ, Neni 44 pika 9, 10]<br>**[EVIDENCA I.2.** Rregullore e UGj, Neni 86, Neni 87, Neni 88]<br>**[EVIDENCA I.20.** Rregullore e FESHSH, Neni 45 pika 5]<br>**[EVIDENCA III.26.** Kodi i Etikës, Neni 23, Neni 24]<br>**[EVIDENCA II.2.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2020-2021]<br>**[EVIDENCA II.3.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2021-2022]<br>**[EVIDENCA II.4.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2022-2023]<br>Studentët, janë të detyruar të respektojnë dispozitat e Kodit të Etikës së Universitetit "Eqrem Çabej" Gjirokastër, për aq kohë sa gëzojnë statusin e studentit në këtë Universitet, përfshirë këtu edhe dispozitat që parashikojnë sjelljen e tyre (*mos kopjimi, mos mashtrimi gjatë procesit mësimor,* |

| | |
|---|---|
| | *plagjiaturat e çdo forme, etj.)* të përcaktuara në Kodin e Etikës.<br>**[EVIDENCA III.26.** Kodi i Etikës, Neni 25, Neni 26] |
| **Kriteri 6.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | UGJ u garanton studentëve të drejtën për vlerësimin dhe marrjen e rezultateve të kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale që bazohen mbi meritë.<br>**[EVIDENCA III.26.** Kodi i Etikës, Neni 8 pika 2]<br>Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. Vlerësimi përfundimtar përbëhet nga vlerësimi i vazhduar dhe vlerësimi në provim. Vlerësimi i vazhduar u jepet studentëve në përfundim të procesit mësimor.<br>**[EVIDENCA I.2.** Rregullore e UGj, Neni 81 pika 1]<br>Teza e provimit, bazuar në Rregulloren e UGJ përmban pyetje që përfshijnë në mënyrë tërësore lëndën përkatëse, dhe për çdo pyetje/ushtrim paraqiten pikët përkatëse.<br>**[EVIDENCA I.2.** Rregullore e UGj, Neni 83 pika 1, 2]<br>Provimi i lëndës zhvillohet me sekretim. Përgjegjës për sekretimin e fletoreve është Përgjegjësi i departamentit ose një person i autorizuar prej tij. Sekretimi bëhet në prani të komisionit.<br>**[EVIDENCA I.20.** Rregullore e FESHSH, Neni 35 pika 7]<br>Rezultatet e vlerësimit përfundimtar jepen në kohë sipas procedurës së parashikuar në Rregulloren e UGJ, Rregulloren e FESHSH dhe në Rregulloren e DHAGJ.<br>Gjatë një viti akademik janë 3 (tre) sezone provimesh për studentët: sezoni i dimrit, sezoni i verës, sezoni i vjeshtës të cilat janë të dokumentuara, dhe kalendari i tyre shfaqet në ambientet e fakultetit. Për studentët që janë në vitin e fundit pas sezonit të provimeve të verës ose vjeshtës shpallet një sezon plotësues, ku vihen data shtesë për provimet e mbartura, me qëllim që studentët të kenë mundësi t'i shlyejnë ato para diplomimit.<br>**[EVIDENCA I.2.** Rregullore e UGj, Neni 85, Neni 90]<br>**[EVIDENCA I.20.** Rregullore e FESHSH, Neni 29 pika 8, Neni 35 pika 6]<br>**[EVIDENCA I.21.** Rregullore e Njësisë bazë, Neni 29 pika 14, Neni 47 pika 13]<br>Pedagogu ka detyrim të pasqyrojë notën e studentit në sistemin Esse3 dhe Pitagora (*të përdorura ndër vite*).<br>Procesverbali dhe fleta shoqëruese që paraqet vlerësimin e vazhduar të firmosura nga komisioni i provimit dorëzohen në sekretarinë mësimore sipas afateve të sanksionuara në rregulloren e UGJ dhe rregulloren e FESHSH.<br>**[EVIDENCA III.28.** Rregullore e Sistemit Esse3]<br>[http://www.uogj.edu.al/wp-content/uploads/Test/upload/Rregullore%20per%20ESSE3%202017.pdf]<br>Aksesi *on-line* për studentët mundësohet me email-in që përdorin në UGJ, duke aksesuar këtë link:<br>[https://www.uogj.esse3.u-gov.rash.al/]<br>Klikoni të logoheni: [https://ulibrary.rash.al/]<br>**[EVIDENCA III.29.** Menaxhimi i platformës software Esse3]<br>**[EVIDENCA III.30.** Platforma software Pitagora]<br>**[EVIDENCA III.31.** Regjistrimi i Pedagogëve në Pitagora]<br>**[EVIDENCA III.32.** Regjistrimi i Studentëve në Pitagora]<br>Në hapësirën *on-line* për studentët në Pitagora, çdo student mund të hyjë dhe të informohet më parë me statusin për notat, detyra kursi, pagesat, data provimesh etj.<br>[https://uogj.pitagora.rash.al/login] |

| | |
|---|---|
| | [http://uogj.edu.al/upload/Posterat_PEDAGOGU_pitagora.pdf]<br>[http://uogj.edu.al/upload/Posterat_STUDENTI_pitagora.pdf] |
| **Kriteri 7.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | Studentët në Universitetin "Eqrem Çabej" Gjirokastër, gëzojnë të drejtën të njihen me vlerësimin e dijeve dhe kërkesën për rishikim të vlerësimit për të gjitha format e kontrollit të dijes të përcaktuara në syllabusin e lëndës, përpara se ky vlerësim të marrë formën përfundimtare dhe njëkohësisht në raste paqartësish, ata kanë të drejtë të rishikojnë personalisht tezën e korrigjuar në prezencë të komisionit të provimit, për të marrë sqarimet e duhura.<br>[**EVIDENCA I.2.** Rregullore e UGj, Neni 90]<br>[**EVIDENCA I.9.** Rregullore e studimeve në UGJ, Neni 45, Neni 46] |
| **Kriteri 8.** Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet. | Çdo kërkesë, ankimim në lidhje me saktësinë dhe korrektësinë e vlerësimit të dijeve nëpërmjet të gjitha formave të kontrollit, të bëra prezent prej studentëve, parashikohen hollësisht në Rregulloren e studimeve në UGJ si dhe në Rregulloren e UGJ.<br>[**EVIDENCA I.9.** Rregullore e studimeve në UGJ, Neni 46]<br>[**EVIDENCA I.2.** Rregullore e UGj, Neni 88 pika 1, 2]<br>Ankesa bëhet me shkrim brenda afatit të ankimimit dhe i drejtohet Dekanit të Fakultetit.<br>Ai përcakton nëse kërkesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës.<br>Në rast se vërtetohen praktika që bien ndesh me rregulloren atëherë me propozim të Përgjegjësit të Departamentit, Dekani vendos për ndryshimin e komisionit të provimit dhe ridhënien e provimit.<br>[**EVIDENCA I.9.** Rregullore e studimeve në UGJ, Neni 46 pika 2]<br>[**EVIDENCA I.20.** Rregullore e FESHSH, Neni 35 pika 18, 19] |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.4**<br>**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve. | Programi i studimit "Bachelor" në Histori-Gjeografi është organizuar në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, për të zhvilluar aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve në fushën e Historisë dhe të Gjeografisë.<br>Veprimtaritë formuese të Programit të studimit janë në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 41, datë 24.01.2018, "*Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë*", Vendimin Nr. 879, datë 18.12.2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa" në Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave, "*Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë*" dhe Vendimin Nr. 185, datë 25.03.2021 "*Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 41", datë 24.01.2018 "Për Elementet e Programeve të Studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë*", të ndryshuar, grupohen në kategoritë e mëposhtme:<br>A. Lëndë bazë, që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen |

Adresa: "Rruga Studenti"
"Lagjja 18 Shtatori", Gjirokastër 6001
Tel: +355 (04) 222-43423
Email: dekanifeshsh@uogj.edu.al
Website : https://uogj.edu.al/

| | |
|---|---|
| | metodologjike dhe kulturën e përgjithshme: 7 lëndë, (36 kredite).<br>B. Lëndë karakterizuese që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik: 16 lëndë (96 kredite).<br>C. Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje: 6 lëndë (25 kredite).<br>D. Lëndë plotësuese, të fokusuara në përftimin e aftësive në gjuhë të huaj, aftësive informatike dhe telematike, aftësive komunikuese e prezantuese, aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës: 5 lëndë (17 kredite).<br>E. Detyrime përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës ose me provimin përfundimtar, (6 kredite).<br>[VKM Nr. 41, datë 24.01.2018]<br>[VKM Nr. 879, datë 18.12.2019]<br>[VKM Nr. 185, datë 25.03.2021]<br>Veprimtaritë formuese, që karakterizojnë këtë program studimi, përbëhen nga komponentët mësimorë, të cilët ndahen në:<br>mësim në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratore), studim individual (studim, punim relacionesh, detyrash apo projektesh, përgatitje provimesh, përgatitje e tezës së diplomës, etj.).<br>I gjithë programi zhvillohet në 34 lëndë mësimore dhe synon thellimin e njohurive dhe aftësimin profesional të studentëve.<br>Në planin mësimor të programit mësimor Bachelor në "Histori-Gjeografi" ekziston një raport i drejtë midis lëndëve me karakter historik dhe gjeografik në numër lëndësh, kredite, të cilat jepen janë të shpërdara në të tre vitet e ciklit të studimeve.<br>**[ANEKS TABELA PËRMBLEDHËSE** - Tabelat 10 Plan mësimor **]**<br>**[EVIDENCA II.2.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2020-2021**]**<br>**[EVIDENCA II.3.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2021-2022**]**<br>**[EVIDENCA II.4.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2022-2023**]** |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit. | Programi i studimit Bachelor në "Histori-Gjeografi" garanton dhe synon zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e shkencave shoqërore respektivisht në fushë të historisë dhe të shkencës së gjeografisë, si dhe në fushat e tjera humane, natyrore etj.<br>Në programin e studimit ofrohen edhe lëndë plotësuese, me zgjedhje dhe ndërdisiplinore, të cilat shërbejnë për plotësimin e njohurive dhe aftësive profesioniale të studentëve në shkencat e historisë dhe gjeografisë, por edhe kërkimit shkencor. Gjuha e huaj është e përfshirë në vitin e parë të studimeve dhe jep një ndihmesë të konsiderueshme në shfrytezimin në vijim të literaturës në gjuhë të huaj si dhe lehtëson oportunitetet e mobiliteteve për studentët në institucione arsimore jashtë vendit.<br>Gjithashtu nëpërmjet lëndës me zgjedhje "*Shkrim dhe Manaxhim Projektesh*" zhvillohen tek studenti aftësitë e menaxhimit, të komunikimit dhe ndërveprimit, të punës në grup, etj.<br>**[ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE** - Tabela 9.2 Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E) (Tabela 9) **Viti akademik 2021-2022]** |
| **Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli | Hartimi, analizimi, shqyrtimi dhe përmirësimi i programeve lëndore organizohen nga grupet mësimore kerkimore nën drejtimin e Përgjegjësit të grupit mësimor-kërkimor.<br>**[EVIDENCA I.2.** Rregullore e UGj, Neni 19 pika 2 gërma b**]** |

Adresa: "Rruga Studenti"
"Lagjja 18 Shtatori", Gjirokastër 6001
Tel : +355 (04) 222-43423
Website : https://uogj.edu.al/
Email: dekanileshsh@uogj.edu.al

| | |
|---|---|
| akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse. | Në syllabuset e çdo lënde të programit mësimor Bachelor në "Histori-Gjeografi", studentët informohen në lidhje me kompetencat, aftësitë dhe rezultatet e të nxënit të fituara në përfundim të saj.<br>**[EVIDENCA II.2.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2020-2021]<br>**[EVIDENCA II.3.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2021-2022]<br>**[EVIDENCA II.4.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2022-2023]<br>Gjatë gjithë procesit mësimor dhe në veçanti në përfundim të lëndës, personeli akademik orienton studentët duke vendosur theksin në temat më të rëndësishme të trajtuara në lëndën mësimore.<br>**[EVIDENCA III.11.** Procedurë për mbylljen e vitit akademik 2020-2021]<br>Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, evidentohen me rezultatet e tyre në format e ndryshme të vlerësimit të vazhduar përgjatë vitit si dhe në provimet përfundimtare. |
| **Kriteri 4.** Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve. | Programet lëndore në programin e studimit Bachelor në "Histori-Gjeografi", kanë të përfshirë rezultatet e të nxënit në formën e kompetencave që fiton studenti.<br>Njohuritë e marra teorikisht zhvillohen më tej në:<br>▪ realizimin e orëve të ushtrimeve/laboratoreve në auditor;<br>▪ studimin individual jashtë auditorit;<br>▪ realizimin e projekteve apo detyrave të kursit, etj.<br>**[EVIDENCA II.2.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2020-2021]<br>**[EVIDENCA II.3.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2021-2022]<br>**[EVIDENCA II.4.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2022-2023]<br>**[ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE** - Tabela 16, Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë]<br>Personeli akademik i DHAGJ-së mbështet diskutimet dhe punën në grup të studentëve në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara, duke krijuar kushtet dhe favorizuar organizimin e punës në grup gjatë orëve të seminareve, seancave laboratorike, detyrave të kursit dhe studimit individual.<br>Gjatë këtij procesi studentët kanë në dispozicion bibliotekën digjitale në UGJ dhe një fond librash, të cilat e ndihmojnë për të zhvilluar njohuritë, për t'u aftësuar në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve.<br>Ky fond ndihmon studentin për studime të përparuara kërkimore shkencore.<br>**[EVIDENCA III.15.** Biblioteka digjitale]<br>**[EVIDENCA III.16.** Manual i Bibliotekës digjitale]<br>[https://ulibrary.rash.al/manual.pdf]<br>UGJ dhe personeli akademik i DHAGJ-së mbështet studentët për të promovuar idetë dhe mendimin e tyre si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të programit të studimit apo në programe mobiliteti, në konferenca, projekte apo seminare studentore, për të nxitur zhvillimin e të menduarit kritik, të menduarit krijues.<br>Gjatë vitit akademik 2022-2023 është arritur një marrëveshje ndërinstitucionale për shkëmbime të stafit akademik dhe studentëve midis Departamentit të Historisë, Antropologjisë dhe Gjeografisë me Escuola De Restauracion Y Bienes Culturales De Madrid, Spanjë.<br>**[EVIDENCA II.27.** Panairi Work & Study 2022]<br>**[EVIDENCA II.28.** Panairi Work & Study 2023]<br>**[EVIDENCA I.32.** Lista e mobiliteteve]<br>**[EVIDENCA III.33.** Përfshirja e stafit dhe studentëve në aktivitetet e Impact Week] |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| | |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit. | Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.<br>**[EVIDENCA III.34.** Plani vjetor i veprimtarive akademike dhe kërkimore-shkencore 2021-2022]<br>**[EVIDENCA III.35.** Plani vjetor i veprimtarive akademike dhe kërkimore-shkencore 2022-2023]<br>**[EVIDENCA I.33.** Lista e mobiliteteve] |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.5**<br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike. | Zhvillimi i provimit të përgjithshëm përfundimtar ose punimi i diplomës për studentët e programit e ciklit të parë Bachelor në "Histori-Gjeografi", mbështetet në Kreun VIII "*Diplomimi*" të Rregullores së Studimeve në UGJ, Rregullores së UGJ, Kreun VII "*Diplomimi*" të Rregullores së FESHSH, dhe në Rregulloren e programit të studimit Bachelor në "Histori-Gjeografi".<br>**[EVIDENCA I.9.** Rregullore e studimeve në UGJ, Neni 59, Neni 60, Neni 61, Neni 62, Neni 63, Neni 64]<br>**[EVIDENCA I.2.** Rregullore e UGj, Neni 93]<br>**[EVIDENCA I.20.** Rregullore e FESHSH, Neni 38, Neni 39]<br>**[EVIDENCA I.21.** Rregullore e Njësisë bazë, Neni 32]<br>Në Rregulloren e studimeve në UGJ, Rregulloren e FESHSH dhe Rregulloren e programit të studimit në "Bachelor" në Histori-Gjeografi përcaktohet qartë pragu i notës mesatare, që i jep të drejtën studentit për të përgatitur dhe mbrojtur një punim diplome.<br>**[EVIDENCA I.9.** Rregullore e studimeve në UGJ, Neni 59 pika 3]<br>**[EVIDENCA I.20.** Rregullore e FESHSH, Neni 39 pika 2]<br>**[EVIDENCA I.10.** Rregullore e programit të studimit, Neni 11 pika b] |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse. | Programi i studimit "Bachelor" në Histori-Gjeografi është program i ciklit të parë të studimeve dhe mbyllet me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome.<br>Në fillim të vitit të fundit të studimeve, DHAGJ asiston studentët duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose mbrojtjes së diplomës, në respektim të Rregullores se studimeve në UGJ dhe shtojcave të kësaj Rregulloreje, Rregullores së Programit të Studimit dhe Programit të provimit të përgjithshëm përfundimtar.<br>**[EVIDENCA I.9.** Rregullore e studimeve në UGJ, Neni 61]<br>**[EVIDENCA II.19.** Shtojcat e Rregullores së studimeve në UGJ mbi tezën e diplomës]<br>**[EVIDENCA I.10.** Rregullore e programit të studimit, Neni 11 pika c]<br>**[EVIDENCA II.17.** Program i provimit të përgjithshëm përfundimtar] |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e | Provimi i përgjithshëm përfundimtar/mbrojtja e punimit të diplomës realizohet përpara një komisioni të posaçëm, të përbërë nga personel akademik të departamentit, të fushave që mbulon programi i provimit të |

| | |
|---|---|
| dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | përgjithshëm përfundimtar. Anëtarët e komisionit propozohen nga Departamenti dhe miratohen nga Dekani i Fakultetit.<br>**[EVIDENCA I.9.** Rregullore e studimeve në UGJ, Neni 62 pika 3, Neni 64**]**<br>Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar është gjithëpërfshirës, me tematika nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit. Programi hartohet nga personeli akademik i DHAGJ-së, miratohet nga Përgjegjësi i Departamentit, si dhe Dekani i Fakultetit.<br>**[EVIDENCA I.9.** Rregullore e studimeve në UGJ, Neni 62 pika 2]<br>**[EVIDENCA II.17.** Program i provimit të përgjithshëm përfundimtar]<br>Tezat e provimit të përgjithshëm përfundimtar hartohen në përputhje me programin e provimit të përgjithshëm përfundimtar nga anëtarët e komisionit, firmosen nga Pergjegjësi i Departamentit dhe miratohen nga Dekani.<br>**[EVIDENCA I.9.** Rregullore e studimeve në UGJ, Neni 62 pika 4**]**<br>**[EVIDENCA III.22.** Formati i unifikuar i tezës së provimit] |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | DHAGJ, në fillim të vitit të fundit të studimeve përcakton fushat e studimeve për punimin e diplomës.<br>**[EVIDENCA II.18.** Miratimi i fushave të studimit për punimin e diplomës]<br>Udhëheqësi i temës së diplomës përgatit programin e punës së studentit duke vendosur afatet e përafërta të realizimit të tij, përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë sipas programit të miratuar.<br>Para mbrojtjes së tezës së diplomës udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studenti dhe lejon mbrojtjen e punimit duke firmosur tezën e diplomës.<br>Punimi i diplomës bëhet duke mbajtur në konsideratë udhëzimet në Manualin e punimit të diplomës, sipas shtojcës bashkëngjitur Rregullores së studimeve në UGJ.<br>**[EVIDENCA I.9.** Rregullore e studimeve në UGJ, Neni 61**]**<br>**[EVIDENCA II.19.** Shtojcat e Rregullores së studimeve në UGJ mbi tezën e diplomës] |
| **Kriteri 5.** Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | Pjesë përbërëse e programit të studimit "Bachelor" në Histori-Gjeografi është edhe zhvillimi i "Praktikës në terren" e cila sipas planit mësimor zhvillohet në vitin e dytë, në semestrin e katërt. Me fillimin e vitit akademik, përgjegjësi i departamentit sëbashku më personelin akademik përgjegjës u komunikojnë studentëve informacionin mbi kohën e kryerjes, programin, mënyrën e zhvillimit dhe mbrojtjes.<br>**[EVIDENCA I.9.** Rregullore e studimeve në UGJ, Neni 34]<br>**[EVIDENCA I.35.** Rregullore e Praktikës në terren**]**<br>**[EVIDENCA I.36.** Progami i itinerarit për realizimin e Praktikës në terren**]**<br>DHAGJ ofron mundësitë për të shfrytëzuar infrastrukturën laboratorike të tij, për përgatitjen e temës së diplomës nën drejtimin e pedagogut udhëheqës.<br>**[EVIDENCA III.12.** Laboratori i Arkeologjisë]<br>**[EVIDENCA III.13.** Laboratori i Gjeografisë**]**<br>**[EVIDENCA III.14.** Projekte në bashkëfinancim me AKSHI (GIS dhe ASPIC)] |
| **Kriteri 6.** Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. | Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë. Vlerësimi i provimit të përgjithshëm përfundimtar ose mbrojtjes së punimit të diplomës pasqyrohet në procesverbalin përkatës. Procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose mbrojtjes së |

Adresa: "Rruga Studenti"
"Lagjja 18 Shtatori", Gjirokastër 6001
Tel : +355 (04) 222-43423
Website : https://uogj.edu.al/
Email: dekanifeshsh@uogj.edu.al

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| | |
|---|---|
| | punimit të diplomës.<br>[EVIDENCA I.9. Rregullore e studimeve në UGJ, Neni 62 pika 5, 6, Neni 64 pika 3, 4]<br>[EVIDENCA II.19. Shtojcat e Rregullores së studimeve në UGJ mbi tezën e diplomës] |
| **Kriteri 7.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Studentët e programit të studimit Bachelor në "Histori-Gjeografi" në përfundim të studimeve pajisen me diplomën, listen e notave dhe suplementin e diplomës.<br>**[EVIDENCA I.9.** Rregullore e studimeve në UGJ, Neni 65]<br>**[EVIDENCA I.2.** Rregullore e UGj, Neni 76]<br>**[EVIDENCA I.20.** Rregullore e FESHSH, Neni 41]<br>**[EVIDENCA II.1.** Regjistrimi i formës së diplomës Bachelor në H-GJ]<br>**[EVIDENCA II.20.** Suplementi i Diplomës]<br>Departamenti depoziton gjithë praktikat e dokumentacionit të vlerësimit. Sekretaria mësimore e fakultetit, depoziton procesverbalet e vlerësimit dhe realizon procedurat e pajisjes së studentit me dokumentacionin e diplomimit, duke vënë në dispozicion kopjen e plotë zyrtare të programit të studimit të zhvilluar.<br>Suplementi i Diplomës për programin e studimit Bachelor në "Histori-Gjeografi" është në përputhje me Udhëzimin Nr. 11, datë 02.04.2020 "*Për përcaktimin e përmbajtjes dhe formës së Suplementit të Diplomës*" të MASR.<br>[Udhëzim Nr.11, dt. 02.04.2020 "Për përcaktimin e përmbajtjes dhe formës së Suplementit të Diplomës" të MASR]<br>**[EVIDENCA II.20.** Suplementi i Diplomës]<br>**[EVIDENCA II.1.** Regjistrimi i formës së diplomës Bachelor në H-GJ] |
| **Kriteri 8.** Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. | Institucioni ruan përgjatë viteve të studimit kopje te dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen. Më pas studentët, në mbyllje të studimit, kanë të drejtë të tërheqin dokumentacionin personal. Të gjitha proceset e ruajtjes dhe përpunimit të të dhënave personale të studentëve nga institucioni kryhen bazuar në parimin e konfidencialitetit dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.<br>UGJ në përputhje me Nenin 101 të Ligjit të arsimit të lartë, Statutin e UGJ si dhe Rregulloren e Sekretarisë Mësimore administron dokumentacionin e mëposhtëm:<br>▪ regjistrin themeltar të studentëve;<br>▪ regjistrin e arritjeve akademike;<br>▪ regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave.<br>**[EVIDENCA I.1.** Statuti i UGJ, Neni 44, Neni 92]<br>**[EVIDENCA I.9.** Rregullore e studimeve në UGJ, Neni 66]<br>**[EVIDENCA III.36.** Rregullore e Sekretarisë Mësimore, Neni 4]<br>**[EVIDENCA III.37.** Rregullore për sigurinë e të dhënave personale] |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| Standardi IV.1<br>**Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij. | Personeli akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, që mbulon programin e studimit "Bachelor" në Histori - Gjeografi përmbush kërkesat ligjore në fuqi, pasi ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit të studimit dhe ka së paku kualifikim të ciklit pasardhës.<br>[Ligji Nr. 80/2015, Neni 25, pika 4, Neni59, pika 3, 4, 5, 6]<br>[**EVIDENCA IV.1.** Rregullore e punësimit në UGJ, Neni 4, Neni 5, Neni 6]<br>Niveli i kualifikimit të personelit akademik që mbulon programin e studimit "Bachelor"në Histori-Gjeografi është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e lëndëve.<br>[**ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE** – Tabelat 6 Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit]<br>[**EVIDENCA III.18.** Europass CV]<br>[**EVIDENCA IV.2.** Model i dosjes PAE]<br>[**EVIDENCA IV.3.** Model i dosjes PAK]<br>[**ANEKS- TABELAT PËRMBLEDHËSE** –Tabelat 12 Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës]<br>Kualifikimet dhe publikimet e personelit akademik pasqyrohen në Raportet Vjetore të DHAGJ dhe në Raportet Vjetore të FESHSH. Këto të dhëna administrohen nga DHAGJ si dhe nga Drejtoria e Burimeve njerëzore dhe protokoll-arkivës.<br>[**EVIDENCA I.15.** Raport vjetor i FESHSH 2020-2021]<br>[**EVIDENCA I.16.** Raport vjetor i FESHSH 2021-2022]<br>[**EVIDENCA I.17.** Raport vjetor i Departamentit 2020-2021]<br>[**EVIDENCA I.18.** Raport vjetor i Departamentit 2021-2022] |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. | Personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore të programit të studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, bazuar në Nenin 59, pikat 3, 4, 5, 6 të Ligjit Nr. 80/2015, "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*" si dhe VKM Nr.418, datë 10.05.2017 "*Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të degëve të tyre*", pika 2, gërma a, nënpika xii, pika 2, gërma b, nënpika i, nënpika ii.<br>[**ANEKS- TABELAT PËRMBLEDHËSE**- Tabelat 12 Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës]<br>[**EVIDENCA IV.4.** Kapacitetet pritëse 2020-2021]<br>[**EVIDENCA IV.5.** Kapacitetet pritëse 2021-2022]<br>[**EVIDENCA IV.6.** Kapacitetet pritëse 2023-2024]<br>[**EVIDENCA IV.7.** Informacion mbi raportin pedagog-student]<br>Personeli akademik efektiv ka së paku kualifikimin e ciklit pasardhës dhe mbulon jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për programin e studimit "Bachelor" në Histori – Gjeografi. |

Adresa: "Rruga Studenti"
"Lagjja 18 Shtatori", Gjirokastër 6001
Tel.: +355 (04) 222-43423
Website : https://uogj.edu.al/
Email: dekanifeshsh@uogj.edu.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. | UGJ garanton dhe dëshmon qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit "Bachelor" në Histori - Gjeografi, për të gjithë periudhën e akreditimit.<br>**[EVIDENCA IV.8.** Listëpagesa e kontributeve 2023]<br>Çdo pedagog ka të nënshkruar kontratën individuale të punës dhe i sigurohet në mënyrë korrekte, të vazhdueshme dhe të pacënueshme mbulimi me sigurime shoqërore dhe shëndetësore). |
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | UGJ harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore.<br>**[EVIDENCA I.1.** Statuti i UGJ, Neni 56]<br>**[EVIDENCA I.2.** Rregullore e UGj, Neni 27, Neni 29]<br>**[EVIDENCA IV.1.** Rregullore e punësimit në UGJ, Neni 3, Neni 5, Neni 8, Neni 9]<br>DHAGJ, bazuar në nevojat e tij, përcakton kriteret e përgjithshme dhe specifike të punësimit të personelit akademik në përputhje me natyrën, strukturën, lëndët mësimore dhe përmbajtjen e programit të studimit.<br>**[EVIDENCA I.2.** Rregullore e UGj, Neni 27]<br>**[EVIDENCA II.34.** Procedurë e rekrutimit të stafit PAE]<br>**[EVIDENCA II.35.** Procedurë e rekrutimit të stafit PAK]<br>Kërkesa për punësim i përcillet Rektorit, ku pas miratimit, publikohet në Buletinin e Prokurimeve Publike si dhe në faqen zyrtare web të UGJ.<br>Rektori me urdhër ngre një komision "*ad-hoc*" për shqyrtimin dhe vlerësimin e kandidaturave për vendin vakant, me 5 (pesë) anëtarë, i përbërë nga Dekani i FESHSH, i cili kryeson komisionin 3 (tre) anëtarësh pjesë e personelit akademik të Njësisë bazë dhe 1 (një) anëtar nga Rektorati. Struktura e menaxhimit të burimeve njerëzore mbështet komisionin "*ad-hoc*" në zhvillimin e procedurave konkurruese.<br>**[EVIDENCA I.1.** Statuti i UGJ, Neni 33 gërma h]<br>Në rastin e konkursit të punësimit të personelit akademik me kontratë, me kohëzgjatje të caktuar si dhe me angazhim me kohë të pjesshme, komisioni "*ad-hoc*" ngrihet nga Dekani i FESHSH.<br>**[EVIDENCA I.1.** Statuti i UGJ, Neni 33 gërma f] |
| **Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | UGJ siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësakademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve praktike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve dhe mjediseve të tjera mësimore.<br>**[EVIDENCA I.1.** Statuti i UGJ, Neni 33, Neni 45]<br>**[EVIDENCA I.2.** Rregullore e UGj, Neni 37]<br>Pjesë përbërëse e DHAGJ në ndihmë të realizimit të orëve praktike dhe mirëmbajtjes së laboratorëve dhe mjediseve të tjera mësimore është 1(një) personel ndihmësakademik me karakter mësimor, i cili zotëron aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës.<br>**[EVIDENCA I.21.** Rregullore e Njësisë bazë, Neni 23 pika 2, Neni 25 pika 1]<br>**[EVIDENCA I.27.** Organograma e UGJ]<br>**[EVIDENCA I.28.** Organograma e FESHSH]<br>**[EVIDENCA IV.9.** Rregullore DSHNA-A] |
| **Kriteri 6.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për | Bazuar në Statutin e UGJ funksionon Sektori i Shërbimeve juridike, personelit dhe sekretari-protokoll, si pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmësakademike-Administrative (DSHNA), e cila është struktura përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave personale të personelit akademik, ndihmësakademik dhe administrativ, parashikuar në |

| | |
|---|---|
| mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ. | Rregulloren e saj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.<br>**[EVIDENCA I.1.** Statuti i UGJ, Neni 41, Neni 42]<br>**[EVIDENCA IV.9.** Rregullore DSHNA-A, Neni 4, Neni 5]<br>**[EVIDENCA IV.2.** Model i dosjes PAE]<br>**[EVIDENCA IV.3.** Model i dosjes PAK]<br>Këto të dhëna përfshijnë Europass CV të personelit akademik, kartën e identitetit, pozicionin e punës, diplomat dhe listat e notave, gradat shkencore dhe titujt akademikë, dëshmitë e gjuhëve të huaja, dëshmitë e trajnimeve dhe kualifikimeve të ndryshme, dëshminë e penalitetit, raportin mjeko-ligjor etj.<br>Përsa i përket promovimit akademik dhe aktivitetit kërkimor-shkencor të personelit akademik, në UGJ funksionon Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë, i cili mbledh, ruan dhe përditëson të dhëna mbi kërkimin shkencor të personelit akademik, pjesëmarrjes në projekte kombëtare/ndërkombëtare, zhvillimit të kapaciteteve didaktike dhe kërkimore-shkencore nëpërmjet mobiliteteve të ndryshme në institucionet e arsimit të lartë jashtë vendit si dhe pjesëmarrjes në trajnime dhe workshop-e.<br>**[EVIDENCA IV.9.** Rregullore DSHNA-A, Neni 17]<br>Të dhënat përfshijnë gjithashtu edhe angazhimin e personelit akademik në çdo vit akademik dhe semestër si dhe planifikimin e kohës vjetore të punës të personelit akademik dhe ndihmësakademik, të dhëna që arkivohen pranë DHAGJ.<br>**[EVIDENCA I.20.** Rregullore e FESHSH, Neni 13, Neni 14, Neni 15]<br>**[EVIDENCA I.21.** Rregullore e Njësisë bazë, Neni 23 pika 2, 3]<br>**[EVIDENCA II.10.** Pasqyrë e mësimdhënies së normuar vjetore]<br>**[EVIDENCA II.11.** Planifikimi i kohës vjetore të punës të Departamentit]<br>**[EVIDENCA II.12.** Planifikimi i kohës vjetore të punës për personelin akademik]<br>**[EVIDENCA II.13.** Planifikimi i kohës vjetore të punës për personelin ndihmësakademik]<br>**[EVIDENCA IV.10.** Kontroll dokumentacioni Janar-Shkurt 2022]<br>**[EVIDENCA III.24.** Regjistër Pedagogu]<br>Në Statutin e UGJ, Rregulloren e UGJ, Rregulloren e FESHSH si dhe Rregulloren e DHAGJ, përcaktohen edhe detyrat e personelit ndihmësakademik me karakter mësimor.<br>**[EVIDENCA I.1.** Statuti i UGJ, Neni 45 pika 3]<br>**[EVIDENCA I.21.** Rregullore e Njësisë bazë, Neni 23 pika 2, 3]<br>**[EVIDENCA II.13.** Planifikimi i kohës vjetore të punës për personelin ndihmësakademik]<br>Mbledhja, ruajtja dhe përditësimi për çdo vit akademik i këtyre të dhënave, bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.<br>**[EVIDENCA IV.11.** Vendime të SA për programin e transparencës]<br>**[EVIDENCA III.37.** Rregullore për sigurinë e të dhënave personale] |
| **Kriteri** 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën | UGJ/FESHSH kanë disa marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e praktikave në terren, temat e diplomave si dhe orë të tjera praktike.<br>**[EVIDENCA I.31.** Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit]<br>Programi "Bachelor" në Histori-Gjeografi nuk e ka të përfshirë praktikën e detyruar profesionale në studimet 3-vjeçare.<br>**[ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE** - Tabela10 Plani mësimor]<br>DHAGJ, në fillim të vitit të fundit të studimeve përcakton fushat e studimeve për punimin e diplomës. |

Adresa: "Rruga Studenti"
"Lagjja 18 Shtatori", Gjirokastër 6001
Tel : +355 (04) 222-43423
Email: dekanifeshsh@uogj.edu.al
Website : https://uogj.edu.al/

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | **[EVIDENCA II.18.** Miratimi i fushave të studimit për punimin e diplomës]<br>Udhëheqësi i temës së diplomës përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur afatet e përafërta të realizimit të tij, përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin, përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë sipas manualit të punimit të diplomës.<br>**[EVIDENCA I.9.** Rregullore e studimeve në UGJ, Neni 61]<br>**[EVIDENCA II.19.** Shtojcat e Rregullores së studimeve në UGJ mbi tezën e diplomës]<br>DHAGJ ofron mundësitë për të shfrytëzuar infrastrukturën laboratorike të FESHSH për përgatitjen e temës së diplomës nën drejtimin e udhëheqësit. | | | |
| **Kriter 8.** Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. | Programi "Bachelor" në Histori-Gjeografi, nuk e ka përfshirë praktikën e detyruar profesionale në studimet 3 vjeçare.<br>**[ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE** -Tabela 10 Plani mësimor] | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | UGJ ushtron aktivitetin e tij në 3 (tre) godina universitare: Godina A me sipërfaqe 3255.5 $m^2$, Godina B me sipërfaqe 1937 $m^2$ dhe godina C me sipërfaqe 729.6 $m^2$.<br>**[EVIDENCA IV.12.** Infrastruktura për kapacitetet mësimore të UGJ 2022-2023]<br>Këto godina janë të ndërtuara me materiale cilësore bashkëkohore të cilat plotësojnë kushtet higjeno-sanitare për studentët dhe personelin akademik, ndihmësakademik dhe administrativ.<br>**[EVIDENCA IV.13.** Akt-Miratim higjeno-sanitar]<br>**[EVIDENCA IV.14.** Vendim SA për Rregulloren mbi masat higjeno-sanitare]<br>Godinat plotësojnë standartet teknike dhe ofrojnë akustikë të mirë dhe janë të izoluara nga zhurmat, luhatjet e temperaturës dhe lagështirës. Godinat shtrihen në qendër të zonës urbane, larg zonave të zhvillimit industrial apo me ndotje, të cilat gjenden në periferi të qytetit.<br>UGJ i plotëson normativat teknike të ndriçimit natyral, sipërfaqja e dritareve mbulon minimalisht 15-20% të sipërfaqes së dyshemesë, ndriçimi është i orientuar nga krahu i majtë i studentit dhe lartësia e ambienteve është jo më e vogël se 3.0m tavan-dysheme. UGJ ka një sistem të mbrojtjes së shkarkesave atmosferike si dhe një sistem të mbrojtjes kundër zjarrit. Çdo godinë është e pajisur me sinjalizues dhe në hollet e çdo godinë janë të instaluara bombola kundra zjarrit si dhe hidratantë, të cilët janë të shoqëruar edhe me sinjalistikën përkatëse. |

Adresa: "Rruga Studenti"
"Lagjja 18 Shtatori", Gjirokastër 6001
Tel : +355 (04) 222-43423
Email: dekanifeshsh@uogj.edu.al
Website : https://uogj.edu.al/

| | |
|---|---|
| | **[EVIDENCA IV.15.** Certifikatë për sigurinë nga zjarri]<br>Institucioni siguron në pjesën më të madhe të sallave dhe zyrave, sisteme ajri të kondicionuar, ndërkohë që Godinat A, B dhe C kanë të instaluar sistemin e ngrohjes së centralizuar (kaldaja). UGJ disponon burime alternative për furnizimin me energji elektrike (një motogjenerator në Godinën B) dhe rezerva të mjaftueshme të ujit të përdorshëm (ujë i pandërprerë 24 orë).<br>Bazuar në Raportin e MAS-së mbi "*Verifikimin e kapaciteteve pritëse për pranimet në programet e studimit, sipas kuotave të deklaruara për vitin akademik 2023-2024*", UGJ ofron një normativë të pritshme mesatare prej 2.5 $m^2$/student, llogaritur kjo në dy fasha orare, kjo normativë shkon në 5 $m^2$/student.<br>UGJ siguron mjedise të përshtatshme në funksion të veprimtarisë mësimore dhe në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit "Bachelor"në Histori-Gjeografi, në përputhje me standartet dhe normativat për infrastrukturën, të përcaktuara në VKM Nr.418, datë 10.05.2017 "*Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe të degëve të tyre*".<br>**[EVIDENCA IV.4.** Kapacitetet pritëse 2020-2021]<br>**[EVIDENCA IV.5.** Kapacitetet pritëse 2021-2022]<br>**[EVIDENCA IV.6.** Kapacitetet pritëse 2023-2024]<br>**[EVIDENCA IV.16.** Kërkesa të Departamentit për buxhet]<br>**[EVIDENCA IV.17.** Mbështetja financiare për veprimtarinë kërkimore-shkencore]<br>**[EVIDENCA IV.18.** Raport vjetor financiar 2020]<br>**[EVIDENCA IV.19.** Raport vjetor financiar 2021]<br>**[EVIDENCA IV.20.** Raport vjetor financiar 2022]<br>**[EVIDENCA IV.21.** Detajimi i buxhetit 2020]<br>**[EVIDENCA IV.22.** Detajimi i buxhetit 2023]<br>**[ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE** - Tabela 16 Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë]<br>Veprimtaritë mësimore si leksionet dhe seminaret e programit të studimit, zhvillohen në Godinën B.<br>**[EVIDENCA III.12.** Laboratori i Arkeologjisë]<br>**[EVIDENCA III.13.** Laboratori i Gjeografisë]<br>**[EVIDENCA III.14.** Projekte në bashkëfinancim me AKSHI (GIS dhe ASPIC)] |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | Për realizimin e programit të studimit "Bachelor"në Histori-Gjeografi, UGJ ka vendosur në dispozicion të DAHGJmjediset mësimore të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që kanë akses të plotë në rrjetin Lan dhe WiFi Internet, në ndihmë të përgatitjes dhe të realizimit të procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënie-mësimnxënies.<br>Sallat e leksioneve dhe të seminareve përmbajnë pajisje projektor dhe laptop (portativ) dhe harta, në funksion të aftësimit teorik dhe praktik të studentëve.<br>Mjediset e institucionit, mjetet informatike e teknike aksesohen në kushte të barabarta për të gjithë studentët, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga procesi mësimor.<br>**[EVIDENCA IV.16.** Kërkesa të Departamentit për buxhet]<br>**[EVIDENCA IV.17.** Mbështetja financiare për veprimtarinë kërkimore-shkencore]<br>**[EVIDENCA III.12.** Laboratori i Arkeologjisë] |

| | |
|---|---|
| | [EVIDENCA III.13. Laboratori i Gjeografisë]<br>[EVIDENCA III.14. Projekte në bashkëfinancim me AKSHI (GIS dhe ASPIC)] |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | Mjediset mësimore në FESHSH përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme, të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik dhe praktik si dhe të objektivave formuese të programit të studimit. Për natyrën e programit të studimit dhe në shërbim të përmbushjes së objektivave mësimore, Departamenti ka një fond të pasur hartash historike dhe gjeografike. Auditorët garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik/praktik. Sipas specifikave të lëndëve apo orëve mësimore vihen në dispozicion Laboratorët e Arkeologjisë dhe Gjeografisë.<br>**[EVIDENCA III.12.** Laboratori i Arkeologjisë]<br>**[EVIDENCA III.13.** Laboratori i Gjeografisë]<br>**[EVIDENCA III.14.** Projekte në bashkëfinancim me AKSHI (GIS dhe ASPIC)]<br>**[EVIDENCA III.25.** Biblioteka e DHAGJ] |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | Në funksion të programit të studimit, për herë të parë u ngrit pranë DHAGJ, Laboratori i SIG-ut, produkt i projekt të miratuar nga MAS, në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit.<br>Ky laborator është i pajisur me programe profesionale në shërbim të natyrës së programit të studimit, për implementimin e GIS në mësimdhënie, aftësimin teorik dhe praktik rreth digjitalizimit të informacionit gjeografik, njohjen e sofware dhe hardware të ndryshëm, të cilët shërbejnë për mbledhjen, përpunimin, ndërtimin e hartave, grafikëve, tabelave etj.<br>**[EVIDENCA III.14.** Projekte në bashkëfinancim me AKSHI (GIS dhe ASPIC)] |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi IV.3**<br>**IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. | Në zbatim të Rregullores së studimeve në UGJ, literatura bazë e detyrueshme përbëhet nga tekstet mësimore dhe ciklet e leksioneve.<br>Literatura bazë dhe ndihmëse u vihet në dispozicion studentëve në formë fizike dhe/ose digjitale, dhe garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në këtë program studimi.<br>Gjithashtu edhe fondi i literaturës fizike dhe online në Bibliotekën e Universitetit mbështet marrjen e dijeve të nevojshme në këtë program studimi.<br>Literatura bazë dhe ndihmëse propozohet nga anëtarët e personelit akademik, shqyrtohet dhe aprovohet nga DHAGJ dhe pasqyrohet në programet lëndore të programit të studimit.<br>Gjithashtu dhe fondi i literaturës fizike dhe online në Bibliotekën e Universitetit mbështet marrjen e dijeve të nevojshme në këtë program studimi.<br>**[EVIDENCA I.20.** Rregullore e FESHSH, Neni 19 pika 7]<br>**[EVIDENCA I.9.** Rregullore e studimeve në UGJ, Neni 27]<br>**[EVIDENCA I.21.** Rregullore e Njësisë bazë, Neni 43/pika 6] |

Adresa: "Rruga Studenti"
"Lagjja 18 Shtatori", Gjirokastër 6001
Tel : +355 (04) 222-43423
Email: dekanifeshsh@uogj.edu.al
Website : https://uogj.edu.al/

| | |
|---|---|
| | **[EVIDENCA I.10.** Rregullore e programit të studimit, Neni 7]<br>**[EVIDENCA II.29.** Miratimi i teksteve mësimore bazë dhe programeve lëndore]<br>**[EVIDENCA II.30.** Procedurë e miratimit të një syllabusi në Departament] |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit. | DHAGJ, përpara miratimit të buxhetit vjetor institucional, paraqet propozimin e tij për përditësimin e literaturës me botime të viteve të fundit.<br>Propozimet e DHAGJ miratohen sipas procedurave përkatëse të Institucionit. Gjithashtu Biblioteka paraqet kërkesa për pasurimin e fondit të saj në çdo fillim viti akademik, duke kërkuar të ketë një zë përkatës në buxhetin institucional.<br>**[EVIDENCA IV.16.** Kërkesa të Departamentit për buxhet]<br>**[EVIDENCA IV.18.** Raport vjetor financiar 2020]<br>**[EVIDENCA IV.19.** Raport vjetor financiar 2021]<br>**[EVIDENCA IV.20.** Raport vjetor financiar 2022]<br>**[EVIDENCA IV.21.** Detajimi i buxhetit 2020]<br>**[EVIDENCA IV.22.** Detajimi i buxhetit 2023]<br>Përveç pasurimit periodik që realizohet me fondet e UGJ, literatura e Bibliotekës pasurohet edhe përmes donacioneve.<br>**[ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE** - Tabela 17 Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/Biblioteka/ Biblioteka online, etj]<br>**[EVIDENCA IV.23.** Fondi i bibliotekës 2021-2023] |
| **Kriteri 3.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | UGJ, në mbështetje të procesit mësimor dhe formimit të tyre professional, vë në dispozicion të studentëve dhe personelit akademik, Bibliotekën Akademike, e cila ndodhet në Godinën C të UGJ.<br>Biblioteka disponon 3 (tre) salla leximi, të cilat janë të pajisura me kompjutera dhe me mjete audio-vizive. Biblioteka disponon një fond të pasur librash në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj, në të cilin gjenden një numër i gjerë tekstesh të fushës së programit të studimit "Bachelor" në Histori-Gjeografi. Biblioteka shërben edhe si sallë interneti.<br>Të gjithë studentët kanë mundësi të barabartë në përdorimin e saj. Literatura mësimore mund të shfrytëzohet në mjediset e Bibliotekës edhe jashtë saj. Studenti disponon një kartelë personale të përdoruesit, përmes së cilës siguron literaturën. Kartela personale e përdoruesit përmban informacione të tilla si numrin e kartelës, emër, mbiemër, atësinë, adresën e banimit, numrin personal të identifikimit, numrin e telefonit, fakultetin, degën etj, si dhe nënshkrimin e përgjegjësit të bibliotekës dhe lexuesit.<br>**[EVIDENCA IV.24.** Rregullore e bibliotekës akademike]<br>**[EVIDENCA IV.25.** Manual përdorimi i bibliotekës akademike]<br>**[EVIDENCA IV.26.** Kartelë personale e përdoruesit]<br>**[EVIDENCA IV.23.** Fondi i bibliotekës 2021-2023]<br>**[EVIDENCA IV.27.** Pasurimi i bibliotekës 2017-2020]<br>**[EVIDENCA III.25.** Biblioteka e DHAGJ]<br>UGJ ka vënë në dispozicion të studentëve edhe përdorimin e librarive elektronike ku ata mund të shfrytëzojnë edhe literaturë në gjuhë të huaj.<br>**[ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE** - Tabela 17 Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj] |
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të | Literatura e ofruar, përmes Bibliotekës është multidisiplinare. Biblioteka është e pajisur me literaturë fizike si: tekste mësimore bazë; literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe në gjuhë të hueja; libra/revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e |

| | |
|---|---|
| huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | të gjitha moduleve dhe veprimtarive mësimore, sipas natyrës dhe specifikës së programit.<br>**[EVIDENCA IV.23.** Fondi i bibliotekës 2021-2023]<br>**[EVIDENCA IV.27.** Pasurimi i bibliotekës 2017-2020]<br>**[EVIDENCA III.25.** Biblioteka e DHAGJ**]**<br>**[ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE- Tabela 17** Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj]<br>Studentët e këtij programi studimi kanë aksesin e mundshëm për shfrytëzimin e fondit të Buletinit shkencor "Kërkime Universitare", Periodik "Shkencat Shoqërore, të Edukimit dhe Ekonomike" si dhe botimet e akteve te konferencave të organizuara nga DHAGJ.<br>Për plotësimin e mungesës së librave institucioni shton fondet për blerje të teksteve bazë dhe literaturës bashkëkohore në ndihmë të studentëve të këtij program.<br>**[EVIDENCA IV.18.** Raport vjetor financiar 2020]<br>**[EVIDENCA IV.19.** Raport vjetor financiar 2021]<br>**[EVIDENCA IV.20.** Raport vjetor financiar 2022]<br>**[EVIDENCA IV.21.** Detajimi i buxhetit 2020]<br>**[EVIDENCA IV.22.** Detajimi i buxhetit 2023] |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit. | UGJ në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, mbështetur nga MAS, ka mundësuar për stafin akademik dhe studentët shërbimin *on-line* të Bibliotekës "U-Library"<br>[https://ulibrary.rash.al/]<br>Në faqen zyrtare web të UGJ, personeli akademik dhe studentët kanë mundësi të aksesojnë *on-line*, literaturë të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit, duke ndjekur udhëzimet e manualit përkatës. Ky shërbim ofrohet pa pagesë për studentët dhe personelin akademik.<br>[https://uogj.edu.al/biblioteka-online/]<br>**[EVIDENCA IV.25.** Manual përdorimi i bibliotekës akademike]<br>Gjithashtu, nëpërmjet abonimit të Bibliotekës në revista shkencore ndërkombëtare *on-line*, studentëve/pedagogeve ju ofrohet mundësia e aksesimit të literaturës në gjuhë të huaj.<br>**[EVIDENCA IV.23.** Fondi i bibliotekës 2021-2023]<br>**[EVIDENCA IV.28.** Trajnime mbi Platformën e Publikimeve UCRIS] |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. | Biblioteka është e pajisur me kompjutera, programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët dhe personelin akademik.<br>**[EVIDENCA IV.23.** Fondi i bibliotekës 2021-2023]<br>**[ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE** - Tabela 17 Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj**]** |
| **Kriteri 7.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | Biblioteka ofron shërbimin për studentët dhe personelin akademik, ditët e javës, e Hënë-e Premte (*me përjashtim të ditëve zyrtare të pushimit*), në orarin 8:00-19:00, në përshtatje me orarin e zhvillimit të procesit mësimor (8:00-14:00), por dhe përtej këtij orari, në përgjigje të nevojave të lexuesve, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. Orari është i afishuar në mjediset e institucionit dhe në hyrje të Bibliotekës. Për çdo student ka kartelë personale të përdoruesit.<br>**[EVIDENCA IV.26.** Kartelë personale e përdoruesit**]** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 8.** Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik. | Biblioteka ndjek dhe raporton mbi cilësinë e fondit fizik të saj dhe fondit *on-line* (*titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit*), përditësimin; shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit *on-line*, nga personeli akademik dhe studentët e programit dhe shfrytëzimin e sallave të studimit, duke nxjerrë në pah efektshmërinë e përpjekjeve për pasurim të fondit fizik, dhe atij *on-line*.<br>**[EVIDENCA IV.23.** Fondi i bibliotekës 2021-2023]<br>**[ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE -** Tabela 17 Të dhëna të plota për platformat on-line/Struktura e teknologjisë së informacionit/ Biblioteka/ Biblioteka online, etj] |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi IV.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | UGJ është pjesë e rrjetit akademik shqiptar RASH dhe QSHA. Nëpërmjet platformave të ofruara prej tyre realizohet procesi i aplikimit dhe regjistrimit *on-line* të kandidatëve (maturantëve U-Albania) në programet e UGJ si dhe matrikullimi i studentëve, bazuar në të dhënat e detajuara të përcjella nga UGJ.<br>**[EVIDENCA IV.29.** Manual shpjegues i Portalit U-Albania]<br>UGJ, në përputhje me Nenin 101 të Ligjit të Arsimit të Lartë, Statutin e UGJ dhe Rregulloren e Sekretarisë Mësimore administron:<br>▪ regjistrin themeltar të studentëve;<br>▪ regjistrin e arritjeve akademike;<br>▪ regjistrin e lëshimit të diplomave dhe certifikatave.<br>**[EVIDENCA I.1.** Statuti i UGJ, Neni 44]<br>**[EVIDENCA III.36.** Rregullore e Sekretarisë Mësimore, Neni 4]<br>UGJ disponon gjithashtu sistemin elektronik Pitagora, aplikacion software i Sekretarisë *on-line*, i zhvilluar nga RASH (*Rrjeti Akademik Shqiptar*), që ofron funksionalitete për administratën, sekretarinë dhe përdoruesit fundorë (studentë, pedagogë etj).<br>**[EVIDENCA IV.30.** Marrëveshje bashkëpunimi UGJ-RASH]<br>**[EVIDENCA III.30.** Platforma software Pitagora]<br>**[EVIDENCA III.31.** Regjistrimi i Pedagogëve në Pitagora]<br>**[EVIDENCA III.32.** Regjistrimi i Studentëve në Pitagora]<br>[https://uogj.pitagora.rash.al/login]<br>[http://uogj.edu.al/upload/Posterat_PEDAGOGU_pitagora.pdf]<br>[http://uogj.edu.al/upload/Posterat_STUDENTI_pitagora.pdf]<br>Disa nga funksionalitetet kryesore të kësaj platforme janë:<br>▪ *Hapësira didaktike:* Struktura akademike, Menaxhimi i karrierës së |

| | |
|---|---|
| | studentit, Provime dhe Tema e diplomës.<br>▪ *Hapësira administrative:* Pranimi dhe regjistrimi, Orari dhe provimet, Menaxhimi i studentëve.<br>▪ *Tarifat:* Menaxhimi i tarifave të studimit, Bursa për studentët, Periudha financiare.<br>▪ *Diplomimi:* Provimet e shtetit, Praktika studentore, Diploma *on-line* dhe Suplementi i diplomës.<br>Në UGJ ka funksionuar për disa vite edhe sistemi elekronik i automatizimit të proceseve të Sekretarisë Mësimore dhe shërbimeve *on-line* për studentët, *Sistemi Esse3*, me funksionalitetet e përcaktuara në Rregulloren e programit të digjitalizimit të Sistemit universitar *Esse3*.<br>**[EVIDENCA III.28.** Rregullore e Sistemit Esse3]<br>[http://www.uogj.edu.al/wp-content/uploads/Test/upload/Rregullore%20per%20ESSE3%202017.pdf]<br>Aksesi *on-line* për studentët mundësohet me email-in që përdorin në UGJ, duke aksesuar këtë link:<br>[https://www.uogj.esse3.u-gov.rash.al/]<br>Klikoni të logoheni: [https://ulibrary.rash.al/]<br>**[EVIDENCA III.29.** Menaxhimi i platformës software Esse3] |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | Në UGJ menaxhimi i dokumentacionit të personelit akademik, ndihmësakademik dhe administrativ realizohet nga Drejtoria e Shërbimeve Ndihmësakademike-Administrative, nëpërmjet Sektorit të Shërbimeve Juridike, Personelit dhe Sekretari Protokoll, e cila menaxhon:<br>▪ regjistrin themeltar;<br>▪ dosjet personale të punonjësve;<br>▪ librezat e punës së punonjësve;<br>▪ çdo dokumentacion tjetër të dhënë nga Rektori/Administratori i UGJ.<br>**[EVIDENCA IV.9.** Rregullore DSHNA-A, Neni 4, Neni 5]<br>Sektori i Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve më Jashtë administron dhe përditëson bazën e të dhënave të kërkimit shkencor, të personelit akademik dhe kërkimor.<br>**[EVIDENCA I.1.** Statuti i UGJ, Neni 82]<br>Bazuar në Rregulloren e FESHSH, DHAGJ ruan me kujdes dokumentacionin përkatës, në lidhje me personelin akademik si: ngarkesën mësimore vjetore mësimore, planifikimin e kohës vjetore të punës mbi mësimdhënien dhe veprimtarinë kërkimore-shkencore, programet lëndore (syllabuset) etj.<br>**[EVIDENCA I.20.** Rregullore e FESHSH, Neni 46]<br>**[ANEKS-TABELAT PËRMBLEDHËSE** - Tabela 4 Ngarkesa totale e personelit akademik të programit Bachelor në "Histori-Gjeografi" në një vit akademik]<br>**[EVIDENCA II.11.** Planifikimi i kohës vjetore të punës të Departamentit]<br>**[EVIDENCA II.12.** Planifikimi i kohës vjetore të punës për personelin akademik]<br>**[EVIDENCA II.13.** Planifikimi i kohës vjetore të punës për personelin ndihmësakademik]<br>**[EVIDENCA II.2.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2020-2021]<br>**[EVIDENCA II.3.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2021-2022]<br>**[EVIDENCA II.4.** Programet e lëndëve (Syllabuset) 2022-2023] |
| **Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e | UGJ nëpërmjet sistemit elektronik Pitagora u siguron akses të dedikuar dhe konfidencial në informacione dhe dokumente, të gjithë personelit akademik, ndihmësakademik dhe studentëve të Programit të studimit.<br>**[EVIDENCA IV.30.** Marrëveshje bashkëpunimi UGJ-RASH] |

| | |
|---|---|
| programit të studimit. | **[EVIDENCA III.30.** Platforma software Pitagora]<br>**[EVIDENCA III.31.** Regjistrimi i Pedagogëve në Pitagora]<br>**[EVIDENCA III.32.** Regjistrimi i Studentëve në Pitagora]<br>[https://uogj.pitagora.rash.al/login]<br>[http://uogj.edu.al/upload/Posterat_PEDAGOGU_pitagora.pdf]<br>[http://uogj.edu.al/upload/Posterat_STUDENTI_pitagora.pdf]<br>Sekretaria mësimore ka akses në llogaritë e tyre, ku shfaqen të dhëna mbi lëndët mësimore, sezonet e provimeve, oraret e tyre, lista e studentëve të regjistruar, procesverbale provimi etj, ndërsa studentët mund të aksesojnë informacione dhe të dhëna rreth statusit të tyre, lëndëve që frekuentojnë, vlerësimeve në çdo lëndë etj. Gjithashtu informacionet dhe dokumentacionet në lidhje me programin e studimit si Rregullore e programit të studimit, Plani strategjik i zhvillimit të DHAGJ 2020-2025, Plani mësimor, Struktura mësimore, Oraret mësimore etj, janë të publikuara edhe në faqen zyrtare web të UGJ.<br>**[EVIDENCA IV.31.** Përditësim i faqes web]<br>[https://uogj.edu.al/] |
